

NOELLE BARKSHIRE
NGA LISI PLAK DHE SHKËMBI
ROMAN

BOTIMET TOENA

NOELLE BARKSHIRE

NGA LISI PLAK DHE SHKËMBI

roman

Përktheu nga origjinali greqisht

Kristo Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Autori: Noelle Barkshire (Noel Baksher)

Titulli në origjinal: ΑΠΟ ΔΡΥ ΠΑΛΙΑ ΚΙ ΑΠΟ ΠΕΤΡΑ

Botoi në greqisht: PSICHOGIOS PUBLICATIONS S.A.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Albina Pulla

Korrektore letrare: Petrina Ago

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Në kopertinë: “Porti i Izmirit gjatë zjarrit të madh” - 1922

ISBN 978-9928-277-19-0

© 2008 Psychogios Publications S.A.

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

*... ti kush je,
pse, them, s'ke dalë nga lisi plak a shkëmbi...*

Homeri, *Odiseja*, Kënga XIX, vargjet 207-208.

Qipro, 1903

Dëgjoja emrin tim dhe u ktheva.

“Penelopë! Penelopë!”

Jashtë dritares, njerëzit nuk pushuan së lëvizuri, ashtu si bëra dhe unë. Bënin ecejake lart e poshtë, hamajtë transportonin ngarkesa të ndryshme duke i mbajtur në sup, dhe karrocierët vazhdonin t'i tërhiqnin karrocet e ngarkuara me mallra.

Mbeta pa lëvizur duke pritur. Dëshiroja të dëgjoja përsëri, të dalloja mirë atë zë të panjohur gruaje, i cili që tani e tutje do të bëhej i afërt për mua.

“Penelopë!”

Rrokja “lo” u dëgjua e zgjatur, ndërsa rrokja “pë” fare e shkurtër. Dy buzë që hapen aq sa të mund të arratiset prej tyre emri im dhe shtrëngohen përsëri. Tingulli doli nga një guaskë, që shqiptoi emrin tim dhe, pastaj, u mbyll përsëri butësisht.

Dadoja ime, Evrikla, më shkundi nga krahu dhe më shtyu drejt derës:

“Kur të thërret jot ëmë, duhet të vraposh tek ajo! Dhe kjo na duhet, të mos bindesh!”.

Kjo ndodhi pak kohë pasi mbërrita në Qipro, së bashku me Evriklën, në shtëpinë e Kallfaxhinjve në Kerinia¹. Atë ditë e mbaj mend disi turbull. Si të ishte një mëngjes me mjegull.

¹ Emri i Kirinias, idiomë vendase.

Sjell ndër mend kujtime, si një shkrepje e aparatit fotografik: dorën e Evriklës, të ftohtë e të lagësht (Sa e çuditshme! Gjithmonë kishte qenë aq e ngrohtë, dhe e butë!), derën e vjetër prej druri me gozhdë metalike në dyqanin e Kallfaxhiut, atë det ngjyrash nëpër rafte, një rreze të shndritshme që depërtonte nëpër baxhë dhe binte si prozhektor mbi një copë kadifeje ngjyrëvishnje. Kam akoma para syve figurën e atij burri të rreptë me mustaqe të dendura, që gjatë kohës kur Evrikla i thoshte ato që duhej t’i thoshte, i ledhatonte, sikur të ishin maçokë, me dorën që ia zbukuronte një unazë e madhe.

Na dërgoi në shtëpinë e tij, disa rrugica më tutje, me një shegert, që gjatë gjithë rrugës fishkëllente. Ishte një shtëpi e bukur, dykatëshe, faqen ballore të së cilës e zbukuronte një ballkon i harkuar. E mësuar me ballkonin e mbyllur dhe të mbuluar të shtëpisë sonë në Aidini, ballkoni i hapur i Kallfaxhiut më bëri përshtypje të madhe. Kaq shumë më pëlqeu ajo shtëpi, sa që më vonë e ndërtova shtëpinë time njësoj si ajo. Të madhe, gjithë dritë dhe mikpritëse.

I tillë ishte dhe ishulli i Qipros në atë periudhë, në fillim të shekullit të njëzetë. I madh, i shndritshëm dhe mikpritës. Lagjet ishin të qeta, dyert e shtëpive të hapura tejteje dhe, nëpër pragjet e shtëpive, mund të shihje ngado stola të ulët, ku uleshin të zonjat e shtëpive.

Për të ecur, shpesh, na duhej të hapnim rrugë mes njerëzve. Kaq të tejmbushura me njerëz ishin rrugët. Dhe jo vetëm rrugët tregtare, por edhe rrugët e lagjeve, që në përgjithësi ishin të pashtuara. Shitësit ambulante që shkonin nga njëri cep i qytetit te tjetri, bënin njëkohësisht dy punë: U sillnin njerëzve mallrat që u duheshin te dera e shtëpisë dhe, njëkohësisht, i argëtonin banorët me lajmet e ditës. Për gratë shtëpiake ishte një rast ideal, që të fshinin duart te përparësja dhe të dilnin në rrugë për të mësuar se çfarë bëhej.

Më të zellshmit prej tyre, i linin mallrat në shesh, në mëshirë të mizave dhe aty ia nisinin bisedës në këmbë. Bënin shaka me orë të

tëra me fqinjët, madje disa herë e tepronin dhe, ndërkohë që flisnin, merreshin njëkohësisht dhe me picirrukët e lagjes, të cilët e kishin si lojë që të fusnin dorën te mallrat që ata tregtonin.

Madje edhe natën vonë dëgjoheshin kalimtarët që bisedonin, si dhe të qeshurat, dhe këngët që përhapeshin nga dritaret e hapura të shtëpive.

Këngët ishin nga më të ndryshmet: këngë qipriote, këngë greke, këngë të Izmirit, këngë patetike dashurie, këngë të Azisë së Vogël, këngë franceze. Të gjitha bashkë, të ndërthurura, ashtu siç i takon një ishulli që gjendet në mes të dy botëve. Kjo ishte Qiproja e asaj periudhe. Një unazë me një gur të vetëm dhe të çmuar. Që herë e vinin në dorën e majtë dhe herë në të djathtë.

Në kulmin e lulëzimit të tij, ishulli i Qipros i uronte mirëseardhjen shekullit të njëzetë, që nuk ishte e thënë të tregohej i mirë me të. Por njerëzit, gjatë dhjetëvjeçarit të parë, i gëzoheshin akoma jetës së tyre, pa dyshuar për asgjë. Dhe vraponin së bashku me fëmijët pas automobilit të parë të qytetit, duke hedhur në ajër kapelat e tyre dhe duke qeshur sa herë që dëgjonin burinë e tij.

Mbërritja në Qipro u bë shumë shpejt, për mua dhe Evriklën, historia jonë e dashur. Një përrallë e jona, që ma tregonte para se të flija. “Evríkla, më trego për kashmirin” i kërkoja unë. Ose “si ishin gurabijet, që më qerasi Katina herën e parë që më pa?”. Kështu i mbaj mend ngjarjet e viteve të mia të fëmijërisë. Si një tregim të gjatë me seri, mbështjellë me ngjyra dhe me aroma.

“Kur vumë këmbën për herë të parë në Kerinia, ishte pranverë”, fillonte të tregonte Evriklë.

“Ishte mëngjes?”, pyesja unë, megjithëse e dija shumë mirë që ishte mëngjes.

“Po, mëngjes. Të mora për dore dhe shkuam drejt e te dyqani i Kallfaxhiut.”

“Më mbaje në krahë?”

“Në fillim të tërhiqja, sepse ishe e lodhur, pastaj të mora në krahë. Më këpute mesin, vajzë shtatë vjeçe dhe nuk kishe turp të të merrja në krahë.”

“Po, pastaj?”

“Gjetëm Kallfaxhiun në dyqanin e tij, duke çmbështjellë mbi banak një top të trashë stofi kashmir. Nuk na priste, u befasua kur na pa. Në fillim kujtoi se isha ndonjë kliente, por si tregtar që ishte, e kuptoi se unë nuk mund të isha kliente për copat e tij. O Zot, çfarë burri që ishte! I gjatë, me atë barkun e tij të madh, me mustaqet e lezetshme.”

“Që i përkëdhelte, sikur të ishte ndonjë maçok.”

“Kjo ndodhi më vonë. Mos u nxito. Që thua ti, i afrohem duke të mbajtur ty përdore, se mos ia mbathje, po si mund t’ia mbathje aq e frikësuar sa ishe, dridheshe si peshku në rrjetë, e gjora ti. Nejse, të mos zgjatem, i afrohem, përkulem dhe ia puth dorën.”

“Atë ku mbante unazën?”

“Të lumtë, atë ku mbante unazën! Dhe çfarë unaze, apo jo? Ai çuditet, por unë nuk ia lëshoj dorën. Me sytë të ulur poshtë, ashtu si ma diktonte mënyra e sjelljes, ia fus në dorë letrën e nënës sate, që e mbaja me vete që nga Aidini. Në atë moment ai na ktheu shpinën, u largua paksa dhe e hapi letrën pak më tutje. Filloi ta lexonte. Dhe vazhdimisht kthente kokën, një herë më vështronte mua, një herë ty.”

“Dhe, çfarë thoshte letra e nënës sime, Evrikla?”

“Nuk e di, zemra ime, ma dha të mbyllur dhe më urdhëroi t’ia jepja vetëm atij. Vazhdimisht të njëjtën pyetje më bën. Edhe pse të kam thënë, nuk më treguan se çfarë shkruhej. Pyet Kallfaxhiun kur të rritesh. Dhe, tani dëgjo vazhdimin, se është i bukur. Gjatë kohës që ai lexonte letrën, të kisha shtyrë përpara meje, që të dalloheshe mirë. Ty, me sa duket, të bëri shumë përshtypje copa e kashmirit mbi banak dhe, a e di se çfarë bëre? Vendose duart e tua të vogla pas shpine, ja kështu, dhe fshehurazi përkëdhelje copën e kashmirit!

Dhe për sa kohë ai studionte letrën, dhe ne, ti aty e kishe mendjen, të fërkoje kashmirin me duar.”

“Fërr, fërr, fërr...”

“Pastaj, na vështroi për një kohë të gjatë. Atëherë ishte momenti kur përkëdheli mustaqet, thua se përkëdhelte një maçok. Më bëri shenjë të afrohesha. Të lashë aty, duke u marrë me copën e kashmirit. Shkroi para syve të mi me nxitim një mesazh dhe thirri, domethënë nuk thirri, por i fishkëlleu njërit prej shegertëve dhe e porositi të na çonte te shtëpia e tij dhe t’ia jepte shënimin që shkroi gruas së tij. Kështu ndodhi, dhe arritëm te shtëpia jote e re.”

“Harrove të thuash se shegerti fishkëllente gjatë gjithë rrugës dhe se ti kujtoje se në Qipro njerëzit nuk flisnin, por fishkëllenin!”

“A nuk kisha të drejtë? Përderisa në fillim askush nuk na fliste. Vetëm fishkëllenin.”

Nga sa më tregoi më pas Evrikla, mësova dhe vazhdimin. Për natën tonë të parë në Qipro. Kështu e kishim quajtur atë histori.

Më tregonte, se përkohësisht na vendosën në një dhomëz të vogël përdhese, përballë asaj të Katinës, kuzhinieres. Atëherë dhoma kishte dy krevate, të vendosura pothuajse ngjitur me njëra-tjetrën, por ishte e pastër dhe e rregulluar me kujdes. Dukej që i përkiste një shtëpie me pronarë të mirë dhe nikoqirë. Evrikla, si një grua e drejtë që ishte, e theksonte vazhdimisht këtë.

Unë flija me gërshetat të shpërndarë mbi jastëk, ashtu si bëja derisa u rrita, si dhe me pëllëmbën e dorës të hapur, që dilte mbi batanije. Ma tregonte dadoja ime se si flija, duke ma marrë dorën dhe duke e vendosur ashtu si e mbaja unë kur flija. Si një pëllumb i vogël, i bardhë, në qiell të ngrysur, kështu i isha dukur atëherë.

Në shtëpi prej kohësh kishte rënë qetësia. Evrikla, rrinte në shtrat e veshur dhe numëronte kohën që kalonte, duke fërkuar gishtërinjtë e saj një e nga një, dhe pastaj përsëri nga e para.

Pasi kishte kaluar njëfarë kohe dhe, pasi i kishte numëruar shumë herë gishtërinjtë, dëgjoi kërcitjen e shkallëve dhe hapat e rëndë që ndalën jashtë derës sonë. Priti. Dera u hap ngadalë dhe hapësira boshe u mbush me trupin e bëshëm të Kallfaxhiut.

I pëlqente që ta përshkruante se sa trupmadh ngjante im atë në atë gjysmerrësirë: “Një gjigant zemërmirë, i gjatë deri në tavan. Trupmadh dhe i dërguar prej Zotit, i gatshëm për të na ofruar mbrojtje.”

Unë kujtoja se ishte ndonjë lutje për fëmijë dhe e përsërisja së bashku me të. “Trupmadh dhe i dërguar prej Zotit, i gatshëm për të na ofruar mbrojtje.”

“Fli”, vetëm kaq i tha ai.

Foli duke pëshpëritur, por zëri i tij, mbante mend dadoja ime, buçiste edhe kur pëshpëriste. Me sytë të ngulur tek unë që po flija, u largua duke e mbyllur përsëri derën pas vetes dhe duke thënë: “Nesër do të flasim për të gjitha ato që duhen thënë”.

Evríkla nuk më tha se çfarë ishin ato që duheshin thënë ditën tjetër. Por as unë nuk mbaj mend që ta kem pyetur atëherë. Dhe, kur më në fund e mendova, isha rritur mjaft. Përrallat kishin kohë që ishin ndërprerë dhe Evríkla nuk ishte më pranë meje.

Kështu mbaron kjo histori: pasi ai mbylli derën, Evríkla u shtri për të fjetur. Por, siç më tregoi, atë natë të parë nuk e zuri gjumi. Me sytë të mbyllur, përpiquej të ambientohej me tingujt dhe aromat e natës së shtëpisë sonë të re. Qëndroi zgjuar, duke thurur ëndrra për jetën tonë të re që po fillonim në Qipro.

Nuk e mbaj mend mirë se kur njoha konkretisht për herë të parë në atë shtëpi nënën time, domethënë nënën time të dytë. Me kalimin e viteve koha i fshin ditët dhe e shkuara bëhet një ditë e madhe. Në atë kohë isha një vajzë e vogël dhe ndodhën shumë gjëra njëherësh. Por, gjithsesi, mbaj mend se ishte shumë e bukur dhe e ëmbël. Dhe mbante aromë, mmm... aromë jargavani, për këtë jam e sigurt. Kur mbërritëm në shtëpinë e saj ishte pranverë. Dhe ajo vetë ishte pranverë. Një lule, me aromë të këndshme, me ngjyra të ndritshme, dhe e butë në përkëdhelje.

Po më mbante në gjunjë. “Moj, sa vajzë e rëndë që qenke! - më pati thënë duke qeshur. “Mos ndoshta është e rëndë dora jote? - kishte marrë dorën time në të sajën, duke e prekur lehtë që nga gishtërinjtë dhe deri lart te supi. - Mos ndoshta është e rëndë kjo këmba e vogël? - dhe bëri të njëjtën gjë me këmbën time, deri lart, te dantella e mbathjeve të mia. - Mos është e rëndë kjo koka e vogël dhe e bukur? - dhe duke u marrë erë flokëve të mi, më puthi në sy dhe në faqe. - Ah, jo, e rëndë është zemra e vogël, sepse është e trembur. Ja shiko, e marr unë peshën dhe e vendos, hop, këtu te zemra ime që është e madhe dhe e nxë këtë peshë. Iku, mbaroi. Tani u lehtësove. U bërë më e lehtë”, dhe më lëkundte te gjunjët e saj duke qeshur.

Më lëkundte dhe qeshte, por edhe zemra e zonjës Kallfaxhi ishte e trembur. Këtë e mora vesh shumë më vonë, vite më pas, kur e dëgjova tek ia tregonte këtë tim shoqi.

“Herën e parë që do të shihja Penelopën, - i thoshte, - kisha ankth... O Zot, sa nervoze që ndihesha. Nuk është e lehtë të shohësh për herë të parë një fëmijë që do ta bësh tëndin!

Besoja se isha e përgatitur mirë për njohjen tonë. Kisha mbledhur të gjitha informacionet e mundshme për vajzën dhe për prindërit e saj, për shtëpinë e tyre dhe për mënyrën se si jetonin në Aidini. U informova madje edhe se çfarë perdesh mbanin, si e shtronin tavolinën, të mund të shihja, pra, pakëz nga jeta e tyre, sikur të isha vetë aty. Kisha planifikuar, gjithashtu, me mendjen time një mënyrë timen se si do t’i afrohesha Penelopës pa e trembur. Me pak fjalë, njohja jonë e parë nuk ishte si ato të rastësishmet që harrohen lehtë.

Por, sapo e pashë, kur Evrikla e sollti në dhomëzën time, shpirti im u ndriçua. Një zemër që dridhej e tëra ishte Penelopa, megjithëse nuk e shprehte. Unë e ndieja. Dhe i harrova menjëherë planet që kisha bërë, si dhe fjalët që kisha përgatitur, dhe lashë zemrën time të fliste. Dhe thua se vështrimi im u bë dritë dhe e tërhoqi vajzën e vogël drejt meje. U afrua tek unë dhe ndenji aty, në prehrin tim.”

E dëgjoja teksa ushqeja me gji mënjanë, larg vështrimit të të tjerëve, vajzën time të vogël. Fliste me zë të ulët, por fjalët e saj kumbonin brenda meje. Dhe heshta. Sepse edhe unë, me zërin e saj, i thosha në atë moment po ato fjalë vajzës sime. E cila, si në rastin e saj, ashtu edhe në rastin tim, nuk ishte vajza ime biologjike.

Nëse nga prehri i nënës sime të dytë kam kujtimet më të ëmbla, prehri i Katinës ka mbetur në mendjen time i mbushur me aroma. Gjëra të skuqura, çyrekë, japrakë, të gatuar me erëzat e saj të çmuara, që i mbante të sigurta në një kuti sekrete prej druri me sirtarë.

Një prehër i stërmadh dhe i ngrohtë, si franxhollat që na piqte, ishte për mua kuzhinierja jonë, Katina. Një brumë i butë dhe i ushqyeshëm, me shumë vende të fshehta, mikpritëse, dhe unë, si fëmijë që isha, më pëlqente t’i zhbiroja. Një kontinent i pafund

mirësie dhe diturie ushqyese autodidakte, që më ftonte për ta njohur.

Tashmë nuk mundem të përshkruaj fytyrën e saj, por mundem akoma edhe sot të pikturoj aromën e saj. Mjafton që të hap në kuzhinë kutinë time të fshehtë dhe vendi të përmbytet nga gatimet e saj të mrekullueshme. M'i mësoi të gjitha recetat e saj të gatimit, një për një, dhe krijoi, për hatrin tim, edhe shumë të tjera. Njohuri që rezultuan të vlefshme.

“Je jetime, - më thoshte herë pas here në kuzhinë, se mos e harroja, gjatë kohës që ‘luanim’, duke pritur që gjella të shteronte, ose kur përgatisnim mishin. - Këto janë pasuria jote. Mbaj mend këto edhe në nevojë, por edhe në gëzim. Janë të vlefshme në çdo moment.”

“Katina, ç’janë këto që thua? Penelopa nuk është jetime! Ka nënë zonzjën Kallfaxhi dhe mua më ka dado!”, hidhej e zemëruar Evrikla, së cilës i hipte gjaku në kokë kur më thërrisnin jetime.

“Ke drejtë, ke të drejtë, - binte dakord edhe Katina, - por... është një jetime me nënë. A nuk është kështu?”, dhe më shtynte me bërryl gjithë nënkuptim, duke shtrembëruar fytyrën që të mos qeshte.

Buzëqeshjen time të parë në familjen time të re ia dhurova Katinës, për një gurabije. Për “një gurabije të vogël me sheqer të bollshëm dhe me bajame të pathërmuara”, siç e përshkruante Evrikla në përrallën tonë të gurabijes.

Ma ofroi Katina në shkëmbim të një buzëqeshjeje nga ana ime, për të parë në të buzëqeshjen e nënës sime të ndjerë, pasi i kishte thënë Evrikla se e kisha të njëjtë me të. U shita, i buzëqesha, dhe që atëherë nuk pushuam së i buzëqeshuri njëra-tjetrës. Me historinë e gurabijes dhe shumë histori të tjera që përjetuam së bashku gjatë viteve pasardhëse.

Por me Katinën nuk qeshnim dhe luanim gjithë kohën. Ajo grua, me origjinë nga një fshat i vogël jashtë Izmirit, kishte dhuntinë e njeriut të pashkollë dhe karizmin e lindur, që njohuritë e saj t’ia

transmetonte fëmijëve. “Gjithçka që bën, si tani, por edhe kur të rritesh, veçanërisht atëherë, ja më shih mua të kam rixha, ta spërkasësh me dashuri, kështu, si shurup. Të mpikset dhe të mos priset me kalimin e kohës. Por jo shumë, që të shkrihet. Të mos jetë as i hollë si ujë. E di ti sa i hedhim bakllavasë, që të lëpjinë gishtërinjtë, aq, që të mos velen. Dakord?”

Dhe unë pohoja me një lëvizje të kokës.

“Të të them dhe diçka tjetër. Edhe mendimet e tua nuk do t’i lëmë kështu, mirë zemra ime? Do t’i zhysim mirë e mirë, në salcën e mirësisë sonë, dakord? Sikur të jenë kafshatë buke në mishin jahni, që të pëlqen aq shumë, mirë?”

Dhe unë përsëri lëvizja kokën në shenjë pohuese.

Në krye të vitit, nga ardhja jonë, lindi Filipi. Erdhi në këtë botë duke shkëlmuar dhe duke bërëtitur “si burrë”. “E si mund të ishte ndryshe djali i parë i Kallfaxhiut?”, komentoni duke qeshur vizitorët tanë, që shtroheshin në shtëpinë tonë deri vonë për të shijuar racionin e dytë, apo të tretë, nga ëmbëlsirat “për meshkuj” të Katinës.

Kështu i quante Katina ëmbëlsirat që u shërbenim duke pritur urimet për vogëlushin. Të gatuaru enkas me rastin e lindjes së fëmijës. Për të sjellë fat.

Qëndroja me orë të tëra mbi djepin e tij, krenare për atë burrë të vogël - vëllanë tim. Dhe kështu, me këto ndjenja, të ëmbëlsuara me sheqerin e ëmbëlsirave tona “për meshkuj”, mendoj gjithmonë për Filipin. Më tepër si një shije në gojë, sesa si një portret. Një shije të ëmbël, pa karakterin disi të ashpër dhe djegës të ëmbëlsirave “për meshkuj”.

Përkundrazi, një portret për mua është Foti ynë, që erdhi në këtë botë një vit më pas, i mbështjellë me një tis drite. “Sollli me vete shkëlqimin e tij”, më tha Evrikla, kur më komunikoi lajmin e mirë. Po përpiquesha të imagjinoja sesi mund të ishte një foshnje që “sillte me vete shkëlqimin e vet”, derisa e pashë për herë të parë.

“E, pra, si të duket vëllai yt i vogël?”, më pyeti nëna.

Nuk i shqisja dot sytë prej tij. “I bardhë, - fola më në fund, - i shndritshëm. Rrezatues!”

Në saje të shkëlqimit që rrezatonte, mori edhe emrin Foti, që do të thotë dritë. “Që të mbesë i shndritshëm gjatë gjithë jetës së tij dhe të na ndriçojë të gjithëve”, u tha të pranishmëve kumbari gjatë ceremonisë së pagëzimit.

Foti lindi duke buzëqeshur, pa britma dhe të qara. I qetë, i kënaqur, si një pako e vogël mbështjellë me pelena në prehrin e nënës së vet, kështu nisi jeta e tij. Të gjithë ishin të një mendjeje se kjo foshnjë ishte një ogur i mirë. Dhe se ky, vëllai im, do të na sillte vetëm lumturi. E vërteta është që na fali shumë dritë dhe shumë gëzim, gjithçka me zemërgjerësi, por për fat të keq, jo në mënyrë të pashtershme.

Im atë kishte një mënyrë tjetër, të vetën, për të edukuar fëmijët e tij. “Preke butë faqen e foshnjës me gishtin tënd, - më inkurajoi ai. - Çfarë ndien?”

“Është e butë. Shumë, shumë e butë. Është fëmijë i bukur.”

“Jo kështu. Mbylli sytë dhe bëje prapë. Çfarë ndien tani?”

“Është si... kadife. Është kadife!”

Kadife, mëndafsh, lino, kambrik, tafta, tyl, puplin. Shumëllojshmëri topash me copa që gjallëroheshin, sapo Kallafxhiu futej në mëngjes në dyqan. Tregtar i njohur copash në të gjithë zonën, që nuk u ngop kurrë së shituri. Të gjitha copat kishin një vend të caktuar në dyqanin e tim ati, që nga ato më delikatet deri tek ato më të ashprat. Ishte i aftë të ndërmernte udhëtime të largëta, “në fund të botës”, për t’u furnizuar me mëndafshet më të mira dhe kadifetë më të buta.

Krenohej se asnjë prej copave që tregtonte nuk mbetej pa u shitur. “Të gjitha kanë çmimin e tyre, - e dëgjoja të thoshte. - Edhe të bukurat, edhe të shëmtuarat. Edhe ato të endurat me cilësi të lartë, edhe ato të tjerat me cilësi më të dobët. Në raftet e mia kam

shumë bija, të çdolloji, dhe të gjithave u bëj unë krushqi”, fliste me humor Kallfaxhiu duke përkëdhelur mustaqet, sikur të ishin një maçok.

I kishte dalë nami i tregtarit të rreptë, por të drejtë, kur bëhej fjalë për të rënë dakord për çmimet: “Ore, si u bëka që të marrësh thuajse falas vajzën time më të mirë? - dhe, kur binin dakord për çmimin me klientin, fillonte ta merrte me të mirë: - Kështu e kanë bukuroshet. Kërkojnë çmimin që meritojnë, - por, kur nuk binin dakord, i thoshte klientit: - Kështu e kanë bukuroshet. Nuk të begenisin. Por për ty kam një tjetër, që me siguri do të të pëlqejë”.

Copat më të mira, më të shtrenjtat, i mbante më vete, i ruante mbrapa tavolinës së tij të punës në një vitrinë të mbyllur me çelës. I ekspozonte gjithmonë me një ceremoni pothuajse fetare, që më ka mbetur e gjallë në mendje.

Fillimisht, para se të vendoste mbi banak topin me copën e çmuar, pastronte vetë dhe hiqte nga banaku të gjitha copat e tjera. I largonte shëgertët duke u bërë vetëm një shenjë, në mënyrë që të mbetej vetëm me klientin. Donte qetësi të plotë, prandaj dhe ia ngulte sytë kërcënueshëm cilitdo prej shëgertëve që bënte zhurmë.

Në vazhdim, fshinte mirë duart me shami dhe fillonte të çmbështillte topin me lëvizje të ngadalta. E merrte me duar dhe e afronte në fytyrë. E vështronte krenar. Fytyra i shkëlqente si e një fëmije, si e Fotit. Pastaj ia afronte klientit shumë afër fytyrës. “Vështroje me kujdes. Ke parë gjë më të bukur në këtë botë? - fliste duke pëshpëritur, por zëri i tim ati nuk i ngjante kurrë një pëshpërimë. - Vështroje tani, ashtu siç i takon të shikohet një copë të tillë. Mbylli sytë dhe preke.”

Nëse klienti hezitonte, ia merrte ai dorën dhe ia mbështeste me butësi mbi copë. Priste të lexonte në fytyrën e klientit sesi do ta shijonte ai prekjën e copës para se të vazhdonte më tutje. “Është e çmuar, - shtonte duke pëshpëritur dhe duke ia ngulur vështrimin

syve të mbyllur të klientit. - E ruaj për time bijë”, përfundonte ai, duke qenë i sigurt se nuk kishte mbetur gjë tjetër pa u thënë.

Pasditeve, kur ritmi i punës binte, dërgonte shpesh shegertin të na thërriste. Shegerti nxirrte kokën te qoshja, por para se ta bënte këtë, fishkëllente. E dëgjonim që nga dhomat tona dhe vishnim shpejt e shpejt palltot.

Kur shkonim në dyqan, Kallfaxhiu, afronte të bijtë pranë vetes te banaku dhe fillonte:

“Pa më thoni, çfarë cope është kjo?

Si e quajmë ndryshe?

Si do ta gjeni në Turqi? Si thamë se quhet në turqisht? Nuk e mbani mend?

Po kjo? Çfarë është kjo?

Po dhe kjo puplin është, ore? Pa më thuaj, ku ndryshon njëra nga tjetra?”.

Dhe, kur vëllezërit e mi pothuajse u rritën, ai u thoshte:

“Sa do të jepje për këtë cohë?

Dhe sa do ta shesësh, ore, nëse e blen me këtë çmim?”.

Asnjëherë nuk binte dakord me çmimet që dëgjonte. “O Zot! - qahej duke shkukur mustaqet. - Ju do të ma mbyllni dyqanin. Kini mendjen në kokë, përndryshe falimentuam. E pat kjo punë. Oh, aman!”

Ua përsëriste vazhdimisht bijve të tij betejën e tregtarëve, një betejë që nuk ka të mbaruar, gëzimin e fitores, që ndryshon nga njëra ditë në tjetrën, “sa gëzim ndien kur xhepin e ke plot falë aftësive të tua”.

Merrte duart e tyre të vogla dhe i vendoste në xhepin e tij, që të shihnin se sa i madh ishte, “një bishë e pangopur, që ushqehet me mund dhe mendje të mprehtë”. U fliste për pësimet e veta, si atëherë kur bleu me gjysmë çmimi mëndafshin më të mirë të Lindjes, por

që të nesërmen mori në dorëzim një top me mëndafsh të mykur, ngaqë një tregtar dinak, më dinak se ai vetë, ia kishte hedhur.

Harrohej deri natën vonë, duke folur për beteja dhe për fitore. I palodhur, derisa shihte djemtë e tij t'ua varej koka mbi banak, ngaqë u vinte gjumi. Ashtu përgjumësh i kthente në shtëpi. Disa herë i mbante mbi shpinë, ngaqë i kishte zënë gjumi, dhe të nesërmen fëmijët kujtonin se të gjitha ato i kishin parë në ëndërr, nuk më besonin kur u thosha që gjithçka ishte e vërtetë.

Në një kohë tjetër, besoj se im atë, ai gjigant me sy të qeshur, do të mund të kishte qenë një luftëtar shumë i guximshëm, ose një rrëfimtari i adhurar përrallash.

E dëgjoja të tregonte historitë e tij, të vishte kaq bukur jetën e tij me fjalë e përshkrime, ndërkohë që unë udhëtoja mes ngjyrave dhe ndijimeve, e mbështetur mbi jastëkë të butë të kadifenjtë. Teksa ai rrëfente notoja edhe unë krah tij, më merrte me vete pesha e tij, ajo shumëllojshmëri ndjenjash që ai i përshkruante pa u lodhur.

Më shoqëronte me figurat e tij të gjalla në udhëtimet e mia drejt së ardhmes, në një tis të purpurt, ku unë e imagjinoja veten grua, të re dhe të bukur, duke shëtitur si spitullaqe, e mbështetur në krahun e një burri shumë elegant, ndërkohë që isha ende fëmijë dhe nuk mund t'ia dalloja fytyrën.

Si një zonjushë e vogël, zgjidhja me kujdes nga duart e tij copat e rrobave të mia të ardhshme, duke kombinuar copa cilësore me ngjyra të ndryshme, dhe duke marrë lehtësisht me mend se kush do të ishin kombinimet më të komplikuar e të guximshme. Mbështillesha deri në fyt me këta gjarpërinj shumëngjyrësh dhe kthehesha e kënaqur për të parë në sytë e tij të qeshur, në sytë e admiruesit tim të parë, jetën e bukur dhe të paracaktuar, siç besoja, të një vajze të rritur.

Nënë, kur të rriten Filipi dhe Foti ynë, si do të dallohen njëri nga tjetri?”

“Çfarë do të thuash, Penelopë?”

“Po ja, kur të rriten dhe të bëjnë siglën e tyre me gerat fillestare si babai?... Do t’i kenë njësoj.”

Kjo kërshtëri fëmijërore më kishte ardhur vetvetiu dhe befas, si një pikëpyetje, ndërkohë që ushtrohesh në bukurshkrim. E ulur, me trupin drejt, me çadrën e vogël të nënës mbështetur me një jastëk pas shpinës së karriges, për të më mbrojtur dhe për të ma mbajtur shpinën drejt, vizatoja artistikisht shkronjat me shumë bishta nga pas.

“E po nuk janë njësoj të gjitha F-të dhe K-të, apo nuk është kështu? Do t’i skicojnë në mënyrë të tillë që të dallohen nga njëra-tjetra”, më ishte përgjigjur nëna nga kolltuku i vogël ku ishte ulur, pa e ngritur kokën nga puna e saj e dorës.

“Ashtu është, por gjithsesi, ata janë vëllezër. Nuk mund t’i kenë siglat shumë të ndryshme”, kisha protestuar unë.

“Mbaro punën, Penelopë!”

“Kam një ide, nënë, dëgjoje! F-ja e Filipit, do ta ketë bishtin nga ana e brendshme, F-ja e Fotit nga ana e jashtme. K-ja do jetë e njëjtë për të dy. Ja, kështu! Si thua?”

“Diçka e tillë”, kishte rënë dakord nëna, duke u hedhur vetëm një vështrim të shpejtë, për të më bërë qejfin.

Gjithë atë pasdite, por edhe disa pasdite të tjera, meqë më ka mbetur kaq e gjallë në kujtesë, ua kushtova siglave të vëllezërve të mi. Shkruaja, skicoja, pikturoja, vetëm F dhe K. Një numër të pafundmë F edhe K. Të pjerrëta, të drejta, të rënda, të imta, të buta,

me bark të dalë, krenare, të çrregullta, lozonjare dhe me bisht të gjatë, të rrepta, të ndërthurura dhe krah për krah.

Në fund, e kënaqur, kisha zgjedhur më të bukurat. Të fisme dhe në krah të njëra-tjetrës, ashtu siç u shkonte për shtat. U emocionova shumë kur më vonë, tashmë të rritur, i prita në Izmir dhe pashë në gishtin e tyre të vogël unazën me inicialet e tyre, ato që unë kisha skicuar atëherë për ta.

Dhoma e nënës Kallfaxhi ishte për ne fëmijët, strofka jonë e dashur. Aty, mbi tapetin e trashë me rombet e mëdha, ecën këmbadoras vëllezërit e mi. Në gjunjë, duke ecur me të katra gjymtyrët, shkoja mbrapa tyre dhe i ndiqja duke luajtur. E mbaj mend shumë mirë se kur hodhi hapin e parë secili prej tyre, duke u mbajtur fort pas gishtit tim. Ditën numëroja hapat e vegjël që ata hidhnin dhe gjatë darkës ua komunikojta krenare kur uleshim për të ngrënë - një arritje, sipas meje, e madhe për një djalë kaq të vogël.

Në atë dhomë, veç shëtitjeve fëmijërore, ne shkëmbyem dhe bisedat tona të para si vëllezër. Si “aaaa”, “ba”, “brr”, “le” dhe shumë të tjera. Gjuhën magjike të fëmijëve të vegjël, të cilën, në saje të eksperiencës me vëllezërit e mi, e flisja me lehtësi më vonë me fëmijët e mi.

Në drekë, kur drita e diellit mbushte dhomën, bënim garë se kush do të shtrihej i pari në tapet, duke zgjedhur, secili për vete, rombin më të mirë, që ndriçohej më shumë prej diellit. Shtriheshim ngjitur, në krah të njëri-tjetrit, dhe shijonim me sy të mbyllur rrezet e diellit, që përshkonin trupat tanë.

Fotit, si më i vogli që ishte, i pëlqente të futej midis nesh dhe shpikte lojëra duke bërë gjoja mundje me Filipin, duke tundur këmbët dhe domosdoshmërisht duke luajtur me gërshetat e mi.

Kishte një burim të pashtershëm hareje vëllai im i vogël. Një

herë e vinte gërshetin tim mbi gojë si mustaqe dhe na fliste me zë të trashë si i ati, një herë tjetër e vinte në formë gjarpri që ngjitej kërcënueshëm mbi fytyrën e tij dhe fishkëllente. Herë të tjera e bënte si litar me lak dhe e hidhte lart për të kapur rrezet e diellit. Ndërsa ndonjëherë e bënte si shpatë të butë dhe luftonte me ngulm kundër armiqve të padukshëm që të na mbronte.

Shpeshherë, me gërshetin tim si byzylyk në kyçin e dorës, e zinte gjumi aty mbi tapet. Unë ia vija pëllëmbën mbi sy që të mos zgjohej nga drita e diellit. Dhe për sa kohë ai flinte, unë e shtrirë përmbys, vizatoja skica mbi tapet. Mërmërisja me zë të ulët këngë, të cilat i kisha sajuar vetë dhe skicoja përsëri rombe duke hequr vija të drejta.

Nëse Foti ynë luftonte që atëherë me armiq të padukshëm, unë, kur isha e vogël, njihja një zonjë, Simonën, që luftonte me armiq realë.

Madam Simona ishte franko-levantine. Kishte ardhur në Qipro nga Gjenova, duke ndjekur pas të dashurin e saj, një italian të pabesë. Fama, që e ndiqte pas si hije, tregonte se në vitet e rinisë kishte qenë kërcimtare. Dhe, më vonë, këngëtare operetash. Vetë ajo, kur u njohëm nga afër, më tregoi, pa asnjë lloj keqardhjeje, se nuk kishte qenë asnjëherë këngëtare.

“Me të vërtetë, në kohën që braktisa kërcimin - apo kërcimi më braktisi mua? *Zut alors*, nuk ka rëndësi - bëja prova me një trupë për të sjellë në skenë një operetë. Operetat, në ndryshim me kërcimin nëpër lokale, sillnin famë dhe fitime të mira. E çfarë tjetër mund të kërkonte një kërcimtare e rëndomtë?”

Kishim dy muaj e gjysmë që bënim prova, a mund ta marrësh me mend? Për dy muaj e gjysmë, aktroja, këndoja dhe kërcëja që në mëngjes e deri në darkë, e uritur dhe pa u paguar, në një depo në gjendje të vajtueshme. Dhe, në fund, vepra nuk u shfaq në skenë.”

“Pse?”

“Për arsye ‘njerëzore’.”

Kur madam Simona përmendte arsyet “njerëzore”, e kishte gjithmonë fjalën për arsye që i ndaloheshin një zonjusheje. Dhe, me këtë frazë, ajo e kyçte gojën.

“Domethënë, dy muaj e gjysmë prova, shkuan kot, madam Simona?”

“Eh, sikur të ishte vetëm kjo që kam humbur në jetën time, *ma cherie*, e dashura ime!”

Duke shkuar mbrapa italianit, si peshk i zënë në grep, Simona, pa e programuar që më parë, ose padashur vetë ajo, mbërriti në Qipro.

Ajo besonte se erdhi bashkë me të, por shpejt zbuloi se, në fakt, kishte ardhur vetëm. Por ishte tepër vonë, apo tepër larg, që të kthehej mbrapsht në Gjenova. Kështu që mbeti këtu, filloi një jetë të re, nga çdo pikëpamje. Me kursimet e fundit që i kishin mbetur nga puna si kërcimtare, bleu një shtëpi në Kerinia - shtëpinë ku shkoja kur isha fëmijë - dhe jetonte duke dhënë mësimë frëngjishteje për zonjat dhe zonjushat.

“Asnjëherë në shtëpitë e tyre, gjithmonë në shtëpinë time. *Parce que je suis une dame, pas une servante.*”¹ Fjalën *dame* e theksonte duke tundur gishtin e zemëruar.

Dyshoj se për këtë, pra, për t’i sjellë nxënëset në shtëpinë e saj, kishte sajuar mënyra që i bënë mësimet e saj më rezultative. Gjatë mësimdhënies, zbriste nga raftet libra dhe i vendoste para nesh, që të na recitonte me shumë pasion, më shumë si aktore sesa si mësuese, pjesë të shkëputura, ose për të gjetur, në një frazë të vijëzuar më parë, edhe një kuptim tjetër për një fjalë të caktuar.

Qëndronte në këmbë, mbështetur në faqen anësore të kasës së derës dhe na shëtiste me zërin e saj tërheqës nëpër Francën e shekullit të nëntëmbëdhjetë, nëpër shtëpi dhe pallate që ne vajzat

¹ Sepse unë jam zonjë, nuk jam shërbëtore (shën. i përkth.).

ëndërronim me sytë hapur. Recitonte në mënyrë të mrekullueshme, pa na lodhur, monologë shumëfaqësh për virgjëresha shëndetliga dhe për bashkëshorte të tradhtuara. Duke ndërruar libër, transformohej në një vajzë të padjallëzuar, ose në një grua me eksperiencë, me po atë lehtësi që, në kapitullin pasardhës, shndërrohej në një zotëri të vrazhdë, apo në një shërbëtor hileqar.

Kur shkonim në shtëpinë e saj për të marrë mësim, na priste edhe ne madje, zonjushat e vogla, çaji nëpër filxhanë, “ashtu siç i ka hije sallonit të një zonje që pret mikeshat e saj”. Si një zonjëz e vogël, merrja e entuziazmuar prej dorës së saj, filxhanin elegant të çajit dhe prisja me padurim se kur do të fillonim udhëtimin, me librat në rolin e qilimit fluturues, për në Francën e periudhës romantike, të cilën, në saje të Simonës, unë mësova ta dua shumë.

Kur u njoha me të, madam Simona me siguri që u afrohej të pesëdhjetave. Rreth asaj moshe sillej për vite të tëra. Por mbetej gjithmonë tërheqëse, megjithëse vetë nuk e pranonte. Elementi i vetëm tërheqës tek ajo, të cilin nuk mund ta braktiste dhe që tradhtonte të shkuarën e saj, ishin gërshetat e saj monumentale, që nuk i bindeshin ligjit të rëndesës.

Ishte bërë e famshme për gërshetat e saj. Zonjat, gjatë kafesë së mëngjesit, apo çajit të pasdites, diskutonin për ta me hollësi. Në shkallë të tillë - sot jam e sigurt për këtë - saqë shumë prej ftesave që i vinin madam Simonës për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore, kishin si synim të kënaqin kërshëritë e zonjave lidhur me parukerinë.

Dikur, me naivitetin tim fëmijëror, iu referova gërshetave të saj të bukur. Por Simona e ndryshoi temën e bisedës, thua se përbënte një temë “njerëzore”: “Të shkretët, *pauvres*, referojnë bukurinë e gërshetave të mi dhe jo bukurinë e shpirtit tim. Budallallëqe!”

Siç u mor vesh më vonë, Simona nuk reshte së kujdesuri për gërshetat e saj edhe kur shtrihej në krevat. Ky zbulim pikant u bë nga mjeku, të cilit një ditë iu desh ta vizitonte në shtëpinë e saj.

Ngaqë ishte e sëmurë, ajo e priti në dhomën e saj. Mjeku mbeti i mrekulluar. Si tregonte më vonë, gjithçka aty i përshtatej më shumë një dashnoreje të ndjeshme, sesa një mësueseje modeste frëngjishteje. Simona, e cila ia kishte lexuar mendimet, si tregonte më vonë ai, i tha nga krevati ku ishte shtrirë: “Doktor, më besoni, me shumë mund, jam bërë tashmë zonjë në sallonin tim. Më lejoni të mbetem grua në dhomën time të gjumit”.

Tregimi i doktorit kaloi gojë më gojë dhe shëtitë në të gjithë qytetin, duke filluar së pari prej gojës së gruas së tij llafazane. Sado që më vonë doktori u mundua të korrigjonte diçka, nuk ia arriti qëllimit. Çdo përpjekje e tij ishte e kotë. Përshkrimet më të pabesueshme rreth dhomës së saj të gjumit, paraqiteshin si absolutisht të vërteta dhe të sigurta.

Por Simona, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, vazhdonte e patrembur të jepte mësimë frëngjishteje dhe të kujdesej për gërshetat e saj, e mësuar me shtrëngatat e jetës. Si një kapitene me përvojë, ajo priste me durim që stuhia të qetësohej. Reagimi i saj i vetëm, pak javë më vonë, ishte që t’i drejtohej një mjeku tjetër, kur pati prapë nevojë për ndihmë mjekësore. Dhe kjo, në mjaft sallone, u interpretua si një fakt tjetër që vërtetonte se të gjitha ato që kishte treguar mjeku i parë, ishin absolutisht të vërteta.

Kjo ngjarje, vërtet kaq e parëndësishme, nuk mbaroi me kaq. Për fatin e keq të mësueses sime të dashur, ajo stuhi u shoqërua me shumë efekte anësore. Shumë muaj më vonë, u dëgjua se Simona duke dashur të bindë të ëmën e një nxëneseje që mësimet t’i ndiqte në shtëpinë e saj, iu referua librave të saj, si dhe pjesëve të shkëputura nga letërsia franceze, duke përfunduar me frazën e pafatë: “Unë, madam, në shtëpinë time nuk u jap zonjushave vetëm mësimë frëngjishteje. U jap mësimë për jetën”.

Por mori një përgjigje që, dhe këtë e them me siguri të plotë,

nuk i takonte asaj gruaje: “Zonjë, do të preferoja që vajzës sime t’i jepnit vetëm mësimë frëngjishteje!”.

Për mua, në moshën e adoleshencës së hershme, Simona kishte qenë një grua tërheqëse, një figurë e pahulumtuar, me shumë anë, të dukshme dhe të padukshme. Për sytë e mi prej fëmije, kombinonte rrezikun joshës të femrës së paarritshme me diturinë e një gruaje me eksperiencë. Ishte njëkohësisht, grua e mirë dhe e keqe. Një e keqe që mori pamjen e gruas së mirë, por e tradhtonin paraqitja dhe aromat që ajo lëshonte: aroma të ëmbla, të përziera, të hidhura, dehëse, por që ishin toksike.

Kjo magjistare përfaqësonte Francën që unë adhurova. Në mënyrë joshëse, zbulonte gradualisht para meje, siç besoja, flladin e saj parisien.

Madam Simona, me një gjest, më ftonte pranë saj dhe më largonte, më lëndonte por edhe më ngushëllonte. Nëpërmjet lojërave fëmijërore argëtuese, ajo më pagëzoi në moshën e adoleshencës, në liqenin e thellë të romantizmit, në furtunën e guximit dhe në detin e qetësuar të sensualitetit të papjekur femëror.

Prindërit e mi nuk kishin nuhatur asgjë prej këtyre zhvillimeve. Kështu që nuk e kuptuan rolin e rëndësishëm që luajti madam Simona dhe librat e saj në jetën time. Frymëzimet e mia romantike në moshën e adoleshencës, shpërthimet e befasishme, si dhe lumenjtë e lotëve që derdhja, justifikoheshin prej tyre me zgjimin brenda meje të instinkteve femërore. Mbjaj mend që Kallafxhiu pati kundërshtime për mësuesen time famëkeqe vetëm në fillim, kur gjithsesi Simona nuk mund të më dëmtonte, sepse kur fillova të merrja mësimë frëngjishteje prej saj, isha në një moshë të vogël.

“Çfarë mund t’i mësojë vajzës sime ajo franko-levantina plëngprishëse?”, e kisha dëgjuar t’i thoshte i zëmëruar nënës sime.

Për fatin tim të mirë, frëngjishtja përbënte një element të

rëndësishëm për një vajzë me pajë të mirë, një konceptim që rezultoi plotësisht i vërtetë në të ardhmen. Kundërshtimi i tim ati ishte zbrapsur falë nënës sime dhe besimit që ajo ushqente se, “një pemë me rrënjë të thella, nuk shkulet, sado me forcë që të fryjnë erërat”.

Duke pasur Simonën mësuese, unë kapërceva, me padurim dhe guxim pothuajse sfidues, distancën që më ndante nga koha që do të bëhesha grua. Me shkopin e saj magjik, u transformova nga fëmijë në një adoleshente dhe, gradualisht, ditë pas dite, hodha shtat derisa më në fund arrita moshën e një gruaje.

Si mirënjohje e papërfillshme, sot gëzohem për faktin që dhuratat e saj atëherë, nuk i prita me duart bosh, i ofrova edhe unë nga ana ime, një dhuratë të vjedhur, dredhinë e “dijes së verbër”, dhuratë nga im atë, Kallfaxhiu.

Kur më lexonte pjesë të shkëputura nga librat, ashtu si të gjitha nxënëseve të saj, unë mbështeteshja te shpina e karriges sime dhe mbyllja sytë. E verbuar, e joshur nga muzikalitetit i gjuhës frënge, e lejoja të më udhëhiqte me zërin e saj shprehës nëpër botët që ajo përzgjidhte.

Duke u ndier e vetmuar, pa asnjë spektator, madam Simona nuk lexonte thjesht rolet në librat e saj, si bënte më parë. Aktronte. Luante rolin e dashnores së braktisur, të bashkëshortes së pabesë, të kamerieres ziliqare, të koketës zemërgur dhe të keqedukuar, dhe, më mirë se të gjitha, rolin tim të preferuar, rolin e gruas që zbulon dashurinë.

Si dëshmitare e verbër e dhimbjes apo gëzimit të saj, e dëgjoja që, me kthimin e një faqeje, të shndërrohej në një aktore protagoniste. E dëgjoja të qeshte me zë kumbues, të qante mbyturazi, të tërbohej dhe të ngrinte gjithë shtëpinë e saj në këmbë, në një mënyrë të tillë, saqë Evrikla që më shoqëronte, hidhej e trembur përpjetë në kuzhinë ku priste.

Në zërin e Simonës, mund të ndieja të ngjethurat e pritjes së të

dashuruarve, drithërimën e prekjeve të para, kujtimet e zjarrta të së ardhmes sime erotike. Symbyllur, prekja me gishtërinj në trupin tim shenjat që kishte lënë dhuna e ëmbël, e habitur që ato përkëdhelje kaq të buta, dhembnin kaq shumë.

Më tërhiqte me vete dhe bashkë me të ecja e pikëlluar në gjurmët e saj të përgjakura erotike dhe ngjitur pas saj vështroja thellë, në brendësi të pusit të pafundmë të pikëllimit të saj erotik.

Disa herë, por jo shpesh, ndërronim rolet. Madam Simona rrinte me sytë të mbyllur dhe më dëgjonte tek lexoja - se unë nuk kisha talentin, apo eksperiencën e saj që të merrja përsipër role - për aktore të përvuajtura, me hire që nuk i gëzonin dot dhe me dëshpërim të shtirur. Prisja një buzëqeshje, apo edhe një lot, për të parë si në një pasqyrë, nëse kisha prekur telat e ndjenjave të saj të panjohura.

Simona thoshte të vërtetën kur fliste për mësimet jete. Asaj ia dedikoj faktin, se provova, pa i përjetuar, pështjellimin e ndjenjave të një gruaje të kompletuar dhe, njëkohësisht, u përgatita mirë për to.

Ia dedikoj asaj, dhe Evriklës së pashkollë, e cila duke mos ditur asnjë fjalë frëngjisht, nuk ishte në gjendje të kuptonte përmbajtjen e mësimëve, dhe e luante shumë keq rolin e rojës që i kishte ngarkuar nëna Kallfaxhi. Në këtë mënyrë, megjithëse sytë e dados sime nuk shqiteshin prej meje, unë, pa provuar puthjen e parë, isha në dijeni të njelmësisë së ëmbël të saj.

Në sallonin e vogël të Simonës unë u kompletova, ashtu si mbushen kallëzat e grurit, duke pirë çaj të ngrohtë nga filxhanët e saj francezë prej porcelani dhe duke pritur me padurim orën që ta mbyllja librin në gjuhë të huaj, që kisha në duart e mia dhe, nga aktore protagoniste, të shndërrohesha në protagoniste të jetës sime.

Më duhej të prisja disa vite akoma. Derisa të merrja formën time si grua, tek unë, herë mbizotëronte fëmija i rritur dhe herë gruaja që nuk ishte kompletuar akoma si e tillë.

Evrikla pështynte dhe bënte kryqin prapa krahëve të mi. Por Katina më qëndronte në krah, duke pritur me padurim që kjo vajzë e vogël e saj të shndërrohej në një grua të vërtetë.

Në kuzhinën e saj ma përshkruante gruan si një gjë të ngrënshme. Si një gjë të ngrënshme, të mrekullueshme, që më bënte të prisja me padurim sa të vinte koha ta shijojta edhe unë. Me fjalët e saj të ëmbla, kuzhinierja jonë më brumosi dhe më bëri grua duke futur me bujari te ky brumë shumë prej elementeve të saj shpirtërore.

Nga nëna ime trashëgova gjeste femërore dhe, pa e bërë qëllimisht, imitoja madje edhe tonin e zërit të saj, me zanoret e zgjatura fundore. Fillova të përdorja edhe unë atë “lo”-në e saj të zgjatur dhe “pe”-në e shkurtër, kështu e shqiptoja tashmë emrin tim.

Por në këngë i qëndrova besnike traditës së Aidinit. Këndonim së bashku me Evriklën këngë të Aidinit, që i kisha mësuar edhe unë dhe e shoqëroja duke bërë zërin e dytë. Evrikla këndonte bukur. Me një zë plot naze, ndërkohë që vetë ajo nuk ishte fare nazelie. E zgjaste mrekullueshëm zërin e saj të hollë, që shprehte dhembshuri. Nëna ime i kishte shumë merak këto këngë. E ngulte gjilpërën me pe te copa që qepte dhe na shoqëronte duke rrahur me butësi pëllëmbët e duarve.

Pasditeve vazhdoja të shtrihesha në tapet si fëmijë, së bashku me djemtë, por e heshtur, e zhytur në mendime të thella duke mos pranuar që ta ndaja me njeri vetminë time. Duke notuar në detin e pafundmë të botës së brendshme të një vajze adoleshente, unë udhëtoja drejt një bote tjetër, larg asaj bote fëmijërore të vëllezërve të mi, duke pasur rombet e tapetit si varkë dhe thekët e tij si litarë delikatë lundrimi.

Me këto mjete të thjeshta udhëtoja unë me shpejtësi, duke pasur si drejtim vitin e shtatëmbëdhjetë të moshës sime.

Penelopë, bëhu gati! Pas dy muajsh nisemi për në Izmir dhe për në Aidini”, më tha im atë natën e ditëlindjes sime.

U befasoja. Pavarësisht udhëtimeve që kisha ndërmarrë gjatë adoleshencës sime, e shtrirë aty mbi tapet, nuk më kishte shkuar ndër mend se një ditë mund të udhëtoja drejt Aidinit. Nuk e kisha në mendje kthimin tim në tokat e të parëve, megjithëse sot e di që është e pashmangshme për dikë që të mos kthehet në vendin ku ka lindur. Deri atëherë, më shumë se kujtimet e mia, afër Aidinit më kishin mbajtur tregimet e Evriklës. Megjithëse larg, ai mbetej afër. Në atë periudhë, vendi i prindërve të mi biologjikë, ishte një vend shumë i largët, të cilin unë e kisha lënë mbrapa. Ashtu si kisha lënë dhe prindërit e mi biologjikë.

Nuk u përgjigja menjëherë. E vështrova tim atë e menduar, ndoshta paksa me dyshim.

“Përse?”, vetëm kaq thashë, më në fund.

Fjalën e mori nëna ime:

“Yt atë po të bën një dhuratë kaq të bukur, moj vajzë fatlume, e vetmja gjë që ti i thua është ‘përse?’”.

Ula kokën nga qortimi që m’u bë. Kafshova gjuhën që të mos thosha përsëri “përse”. Por këtë kisha në majë të gjuhës dhe e kuptuan.

“Pa afrohu, bija ime, që ke plot enigma dhe pyetje”, më tha im atë.

Iu afrova, ai më uli te gjunjët e tij, ashtu si bënte me djemtë e tij. Kokën e mbaja akoma ulur dhe vështroja këpucët e mia, që dukeshin kaq të vogla afër këpucëve të tij gjigante. Ma ngriti

kokën që ta vështroja në sy. Megjithëse kokën e kisha ngritur lart, vështrimi im nuk shqitej prej dyshemesë.

“Ah, këta sy! - psherëtiu ai. - Ah, ata qiejt e tu të vegjël! Një herë janë gjithë re, se janë të hidhëruar. Herën tjetër shkrepitjnë nga zemërimi. Tjetrën, nga ta rrjedhin lotët si lumenj. Por janë më të bukur, - dhe më pickoi faqen, - kur shkëlqejnë nga lumturia.”

Qesha fshehtazi me krahasimet që bëri. U kënaqa që sytë e mi i quajti qiejt. U kënaqa veçanërisht sepse e kuptova që i pëlqente të vështronte qiejt e mi. I drejtova një vështrim të zgjatur, qëllimisht enigmatik, që t’ia ngatërroja mendimet.

“Pa të shohim, pra, si janë tani qiejt e Penelopës, - tha dhe mbërtheu vështrimin e tij në sytë e mi, duke marrë një qëndrim hetues, si një dijetar që kishte studiuar shumë dhe që ishte specializuar në parashikimin e fatit duke vështruar sytë. - Aha, po shoh dy diej, por mbrapa disa reve të vogla, të parëndësishme. Pa prit një herë, t’i fryj dhe t’i dëboj.”

Kështu na fliste im atë ne fëmijëve. Sikur të ishte edhe vetë fëmijë. Dhe ishte fëmijë. Një gjigant me zemër fëmije. Ashtu sikundër e përshkruanim me Evriklën në lutjen tonë të vjetër: “Gjigant dhe i dërguar prej Zotit që të na mbrojë”.

“Të flas a thua se je fëmijë, ndërkohë që ti je vajzë e rritur. Dhe, çfarë vajze! Zonjusha më e bukur e Kerinias është ulur mbi gjunjët e mi.” Më dha një të shtyrë të lehtë dhe më ngriti më këmbë. E kapi për krahu nënën time dhe duke ecur, më tha: “Eja të bisedojmë si të rritur”.

E gjeta në sallon duke rruftitur kafënë, me kokën paksa të ngritur dhe duke lëpirë buzët. Fliste seriozisht, ashtu si dëgjoja burrat të flisnin midis tyre. Shkurt dhe saktë. Krejt ndryshe nga unë, që flisja rrëmbyeshëm, siç flasim gratë.

Krenare që më fliste sikur të isha e barabartë me të, varesha nga ato që shqiptonin buzët e tij. Më tërhiqte ajo mënyrë të foluri, e

thjeshtë. Me ndonjë krahasim apo metaforë që përdorte aty-këtu, lejonte të dilte në sipërfaqe edhe karakteri fëmijëror i tij. Apo ndoshta kështu dëshiroja ta interpretoja unë. Ishin kode sekrete të gjigantit tim, që kisha privilegjin të dija t'i deshifroja.

Po atë natë, me fytyrën që më shkëlqente në errësirë, i tregova Evriklës bisedën “burrërishte”, të cilën, meqenëse e kuptoja, kujtoja se edhe mund ta flisja. Kisha kopjuar si papagall fjalët e tim ati. Madje krenohesha me vete që isha në gjendje të mbaja mend edhe krahasimet. Prandaj u zhgënjeva pak kur dëgjova Evriklën të më thoshte në errësirë: “Fol si njeri, pra! Ç’gjuhë sorrash është kjo? Fol se mezi po pres!”.

Shfryva me ngadalë, të mos dëgjohesha. Por lajmet ishin më interesante se biseda “burrërisht” dhe nuk më interesonte shumë.

I tregova për udhëtimin tonë. I thashë se do të shkonim të tre, im atë, ajo dhe unë. Se do të niseshim në fund të pranverës dhe se ndalesën e parë do ta bënim në Izmir, ku im atë kishte disa punë. Nga Izmiri do të shkonim në Aidini, me qëllim që unë të njihesha me të miat.

“Cilat janë këto të tuat?”, nuk u përmbajt Evrikla dhe më ndërpreu.

“Kështu më tha: *Të njihesh me gjërat e tua.* Dhe më vonë më shpjegoi se e kishte fjalën për pronat e mia dhe vendin ku kisha lindur.”

Megjithëse nuk mund ta shikoja, e ndjeva se Evrikla buzëqeshi e kënaqur. Madje e dëgjova buzëqeshjen e saj, kaq e qartë ishte.

U ngrit nga krevati i saj dhe u afrua tek unë me lëvizje të ngadalta, që të mos trembesha. U ul në cep të krevatit tim dhe më vështronte në errësirë. Nxora dorën nga poshtë mbulesave që ta prekja.

“Si një pëllumb i bardhë në një qiell të vrenjtur”, pëshpëriti.

Ma ledhatoi dorën, sikur ledhatonte një zog të trembur. Me butësi dhe ngadalë, nga gishtat e deri te qafa.

Me po atë butësi dhe po aq ngadalë, sikur po ledhatonte një zog me zërin e saj, më pyeti: “Penelopë, je e frikësuar që do ta shohësh përsëri Aidinin? Nuk e mban mend vendin tënd? Prandaj?”.

“Nuk është kjo, Evrikla. E mbaj mend pak. Nuk mund ta imagjinoj sesi do të jem, sesi do të ndihem, kur ta shoh përsëri.”

“Aty janë rrënjët e tua, e harrove? Ti nuk dëshiron që t’i presësh ato rrënjë, apo nuk është kështu?”

Bëra një gjest pohimi në errësi, por ajo nuk e pa.

“Apo jo, Penelopë?”

“Po, - aprovova instinktivisht unë. - Nuk dua t’i pres, - por në vazhdim, nga goja ime rrodhën me rrëmbim fjalët: - Por kam frikë se mos dëshpërohem. Gjithashtu kam frikë se mos nuk dëshpërohem. Kupton? Kam frikë se nuk do të duroj t’i shoh, të shoh përsëri shtëpinë time. Kam frikë se do të më dhimbsen. Ashtu siç dridhem se mos ndoshta të gjitha ato do të më duken të huaja e nuk do të më dhimbsen. Të huaja dhe pa interes. Ikëm nga Aidini atëherë, dhe ato ikën prej nesh, duke mbetur pas. Mbetën në të shkuarën dhe sot me vështirësi i kujtoj, kaq larg janë. Ne tani dëshirojmë t’i sjellim përsëri në të tashmen. Përse?”

“Sepse ato janë rrënjët e tua dhe ajo është e shkuara jote. Ja përse, budallaçkë! Mund edhe t’i harrojmë, por i mbartim me vete.”

“Si hijen tonë, domethënë?”

“Si hijen tonë. Prandaj ajo duhet të jetë e bukur, e ndershme dhe e sistemuar bukur”, plotësoi Evrikla, e cila nuk e humbi rastin të më jepte edhe një mësim tjetër.

“Sido që të jetë, të gjitha hijet të zeza janë”, ia ktheva unë.

“E ke gabim, vajzë pa eksperiencë, që kujton se i di të gjitha. Ekzistojnë disa hije të shndritshme që të verbojnë.”

Vazhdova duke i lënë mënjane hijet: “Gjithashtu kam frikë se kur të kthehem në Qipro... do të jem njeri tjetër. E huaj mes të afërmve të mi... Mendoj edhe për çiftin Kallfaxhi, se mos dëshpërohen që e bija e tyre do të shkojë për t’u bërë homazhe prindërve të saj. Largohem nga shtëpia ime për të shkuar në një shtëpi, e cila është

shtëpia ime, por edhe nuk është shtëpia ime”, përfundova me një ton dramatik, duke e lënë gojëhapur Evriklën e shkretë.

Heshtëm për pak, duke vënë rregull në atë mori shtëpish dhe prindërisht që kishin zënë vend në mendjet tona.

Heshtjen e theu dadoja ime: “A të kujtohet ndopak shtëpia jote, Penelopë? Shtëpia jote e parë”, sqaroi ajo.

“Më kujtohet pamja e saj, më vjen ndër mend si një pikturë”, iu përgjigja vetvetiu. “Si një pikturë shumë e bukur, që e pashë dikur, diku, dhe e kam lënë diku.”

“E ke gabim, zemra ime. E mbart brenda vetes sate.”

Kështu, nga njëra ditë në tjetrën, shtëpia u bë rrëmujë nga përgatitjet e udhëtimit. Baulet u nxorën nga depoja dhe u lanë në oborr që të ajroseshin. Rrobat e bardha u lanë përsëri një për një. Rrobalarëset dhe shërbëtoret përveshën mëngët që gjithçka të ishte gati, a thua se do të niseshim të nesërmen. Hapat e tyre që dëgjoreshin nëpër shtëpi, ngjanin me galopin e kuajve.

Bagazhet u përgatitën kaq shumë herë, saqë u lodhëm së numëruari. Secili kishte mendimin e tij se çfarë duhej të merrnim me vete. Mendime, këshilla dhe porosi, të përziera në një fjali. “Mos këtë...” “Mos harro atë.”

Në kuadër të atij nervozizmi të përgjithshëm, gjithçka mund të bëhej shkas për shumë zënka të vogla. Të gjithë grindeshin me të gjithë, për gjërat më të parëndësishme. Madje edhe Katina, njeriu më fjalëmbël i asaj shtëpie, për disa ditë nuk fliste me Evriklën. Por gjatë orëve që im atë ndodhej në shtëpi, mbretëronte armëpushim i përgjithshëm. Me të dëgjuar derën e jashtme që hapej, gjithçka binte në qetësi si me magji dhe, secila prej nesh, fshehtas njëra nga tjetra, shfrynte e lehtësuar.

Nëna ime mori rrobaqepëse që të më qepte rroba të reja. “Kur të shkosh në Izmir të jesh më e bukura ndër vajzat më të bukura”, më lavdëronte ajo.

Natyrisht, copat për të qepur rrobat e mia, i zgjedha në dyqanin e tim atë. Gjatë kohës që unë vështroja me kujdes topat e pëlhurave nëpër raftet që të zgjidhja, ai qëndronte mënjanë dhe më ndiqte me sy, me dorën të mustaqet.

Ledhatoja pëlhurat pa u nxituar, ashtu si më kishte mësuar ai. U kërkova shëgertëve të më zbrisnin nga raftet topa që nuk i arrija, pastaj edhe topa të tjerë, derisa banaku u mbush plot dhe po më merreshin mendtë. Në vazhdim, u tregoja me gisht që të hiqnin copat që nuk më pëlqenin dhe Kallfaxhiu, me një të fishkëllyer, i udhëzonte që urdhri im të zbatohet menjëherë. Derisa përfundova te copat më të bukura.

Dhe atëherë ktheva kokën nga im atë duke kërkuar vlerësimin në vështrimin e tij. Duke më shkelur syrin, një sy që ende qeshte, më kapi për krahu që të iknim dhe, me një fërshëllimë, porositi shëgertët që të na i sillnin copat në shtëpi.

Zgjedhjen e copave ma lanë në dorë mua, ndërsa për modelet e rrobave të mia të reja, këmbënguli që t'i zgjidhte nëna ime, duke ma ndaluar kategorikisht që të shfletoja revistat e modës së madam Simonës. Për të mos u dorëzuar para lumit të lotëve që derdha, nëna shpërtheu mbi Evriklën, të cilën e vura të ndërmjetësonte për hatrin tim. Madje, e njësuar me klimën e nervozizmit që mbizotëronte në shtëpi, në fund u grind edhe me veten e saj, që më kishte lejuar të ndiqja mësimet e frëngjishtes. “Dhe kjo na duhej, moj e shkretë, që të imitosh dhe gërshetat e saj”, më kërcënoi e zemëruar.

E mbajta fjalën dhe nuk imitova gërshetat e madam Simonës. Por imitova mënyrën franceze të sjelljes së saj. Ose, le të themi, mënyrën pothuajse franceze të sjelljes së saj. Sigurisht që në atë periudhë, unë i konsideroja ato sjellje parisiane origjinale. Por në realitet, kishim të bënim me një përzierje *savoir vivre* masiv francez, sfilatë popullore italiane dhe fantazie krijuese të madam Simonës.

Nga ky aliazh unë zgjodha për udhëtimin tim të parë në Izmir, mënyrën si t'u jap dorën zotërinjve me dozën e duhur të ndrojtjes, si t'i përhëndes me edukatë zonjat, si të tregohem delikate në masën e duhur, si të buzëqesh dhe kurrë të mos qesh, si të fsheh me elegancë mërzinë time.

Simona u përpoq gjithashtu të më mësojë gjuhën ndërkombëtare të syve. Si të flas me sy. I lamë librat mënjanë dhe, në kuadër të udhëtimit që do të ndërmerrja, bënim prova para pasqyrës për të gjitha shprehjet e mia të fuqishme: surprizë, zemërim, mister, kënaqësi, mohim, përbuzje, pranim. Siç më tregoi më vonë, e la për në fund më të vështirën: vështrimin që do t'i joshte edhe gurët.

“Të gjitha gratë do t'ia shisnin shpirtin djallit për ta mësuar, bukuroshja ime, më dëgjo mua, - më ngushëlloi ajo kur unë i braktisa përpjekjet, e pakënaqur nga pamja ime si karikaturë, që as i afrohej joshjes. - Por janë të pakta në botë ato që ia kanë arritur, numërohen me gishtërinjtë e njëres dorë”, shtoi ajo duke m'i rrahur shpatullat në mënyrë ngushëlluese që nuk po ia arrija.

Më erdhi turp ta pyesja nëse ajo ia kishte arritur. Për më tepër, e dija përgjigjen: çështje “njerëzore”.

Por nuk m'u durua dhe, në një moment, kur m'u dha mundësia që të mos ngjallja dyshime, pyeta larg e larg Katinën. Me mënyrën e saj magjike, domethënë të bënte pyetje pa pyetur dhe të informohej pa qenë nevoja që ti të flisje, ajo nuk e pati të vështirë ta zbulonte dëshirën time të fshehtë, domethënë të joshja, si grua, edhe gurët. Në vend të përgjigjes, për herë të parë pas kaq vitesh që e njihja, më hodhi një vështrim të tmerrshëm me bisht të syrit, nga ato vështrimet e helmatisura që deri atëherë i kishte rezervuar vetëm për Evriklën.

Ishte një vështrim që thyente edhe gurë. Pa e marrë aspak mundimin të kthente kokën, më dërgoi papritur një vështrim të zjarrtë si vetëtimë që përmbante mijëra shpata të zjarrta. Më dhëmbi kaq shumë mënyra se si më dekurajoi Katina.

Vrapova të fshihem në dhomën time duke qarë, por e dëgjoja akoma të më thërriste nga shkallët e katit përdhes: “Një gur ka më tepër tru se koka jote boshe! Ç’kujton ti moj, cila grua, që e ka mendjen në vend, do të lutej që të joshite një gur? Dëgjon ti, të joshë gurë! Nuk ka tjetër punë për të bërë. Trutharë! Zbrit menjëherë tani poshtë që të sqarohemi”.

Por nuk guxova të zbrisja. As të nesërmen dhe as të pasnesërmen. Me përbuzje dhe zemërim, vendosa se nuk doja të dëgjoja përsëri për gurë që joshen.

Por përfundimisht nuk munda t’i shmangesha, dëgjoja përsëri për gurë që joshen. Kur zbrita përsëri në kuzhinë, e turpëruar dhe me vështrim përdhe, Katina i la lugët mënjanë dhe më mori në prehër. Mora frymë e lehtësuar që e gjeta, si përherë, të ngrohtë dhe me aromë të mirë, si një franxhollë e sapopjekur.

“Pa afrohu, franxholla ime e vogël”, më thirri ajo me emrin e vjetër përkëdhelës.

U ulëm në të njëjtin stol, ngjitur njëra me tjetrën. Qëndroja e heshtur, e turpëruar.

“Budallaqe! Moj, çfarë franxhollë, hallvë do të të thërras tani e tutje. Hallvë!”

Buzëqesha edhe unë me emrin e ri përkëdhelës.

“A mundet, moj hallvë, të joshet një gur? Madje edhe po ta ketë vështruar më koketa prej grave! Asaj do t’i dhëmbin sytë, por guri aty do të mbetet. Gurin, shpirti im, e gdhend që ta bësh të bukur, ose e thyen me shumë mund. Por nuk joshet. Mirë?”

“Mirë”, pohova unë duke tundur kokën.

“Le t’i lëmë tani, them unë, gurët me gurët, dhe të gatujmë pak hallvë që të joshim gjuhën tonë. Si thua?”

Tunda përsëri kokën në shenjë pohuese.

“Mos ke pirë gjë Ujin Memec, apo joshja e tepërt të ka fishkur gjuhën?”, më ngacmoi ajo që të më bënte t’i flisja.

Nuk iu përgjigja. Vetëm i hodha një vështrim plot dhimbje dhe, pak nga pak, sytë filluan përsëri të më mbushen me lot.

“Moj, po i lumtë atij guri për hatrin e të cilit po qajmë!”

“Katina!”, i thashë duke shpërthyer në dënesa dhe fsheha kokën për të qarë në prehrin e saj të bollshëm.

Më në fund dita e nisjes po afrohej. Pranvera me aromat e saj po na përgatiste për udhëtim. Ditën i linim dritaret hapur dhe e ftonim të futej në shtëpi. Nëpër dhoma përhapej një aromë e këndshme. Aromat pranverore futeshin deri te baulet tona, që i mbanim të hapura, për t'i marrë dhe ato me vete, si udhëtare klandestine në anije së bashku me ne.

Çdo ditë të re që agonte, numëronim gonxhet e reja që çelnin gjatë natës, aromën e të cilave e ndienim së bashku me ajrin që thithnim. Një, dy, tri... Prisinim të shijonim aromën e tyre kur ato të çelnin. Atëherë do të mbyllnim baulet tona e do të bëheshim gati për udhëtim.

Gjendja e mirë shpirtërore për shkak të ardhjes së pranverës, si dhe gëzimi i udhëtimit të shumëpritur, dolën fitimtarë mbi nervozizmin tonë. Në një mënyrë apo në një tjetër, ishte ulur numri i shkaqeve që çonin në grindje të vogla, përderisa përgatitjet më të shumta kishin përfunduar. Ditët e fundit para udhëtimit i kalonim me të afërm dhe miq, të cilët vinin për të na uruar rrugë të mbarë.

Për këtë rast gatua më së bashku me Katinën gjellë me receta nga Izmiri, dhe si ëmbëlsirë bëmë bakllava. Pjatancat futeshin e nxirreshin nga bufeja dhe unë çdoherë, provoja fshehtazi ato gatime të shijshme. Padurimi më kishte bërë llupëse. U përmbajta nga frika se derisa të arrinim në Izmir, do të shëndoshesha dhe rrobat e reja nuk do të më bënin.

Një mëngjes, në kuzhinë, Katina hapi dritaren e vogël dhe bëri mënjane e befasuar që të lejonte pranverën të futej brenda. Aromat

e forta të erëzave të saj, si yshtjet e dimrit, e kishin mbajtur deri atëherë pranverën larg kuzhinës.

“Erdhi pranvera”, më komunikoi, gjë që të gjithë e dinim prej ditësh.

Ardhja e pranverës e bëri Katinën melankolike, gjë që nuk përkonte me humorin tonë të mirë. Ajo, që nuk pushonte së foluri, që u fliste gjellëve dhe enëve të saj të kuzhinës duke besuar se kishin veshë për ta dëgjuar, tani heshti. Dëgjonim vetëm tingujt e enëve. Dap-dup. Tinguj vetmitarë dhe të përvajshëm.

“Nuk do t’u flasësh?”, e pyeta pas shpine, teksa ajo po lante një tenxhere të madhe.

Katina psherëtiu kaq thellë, saqë pashë supet e saj të ngriheshin dhe të uleshin.

“Çfarë mund t’u them?”, m’u përgjigj në një mënyrë, sikur donte të më thoshte: “Nuk kam asgjë për t’u thënë”.

“Hajde të të laj, tenxherja ime e artë. Hajde, se nesër përsëri bashkë do të gatuajmë. Çfarë po ndodh me ty, Katina? Nuk do të më thuash mua?” Nuk më tha asgjë. Prita pak, sa të sigurohesha, dhe fillova përsëri: “Dakord, tenxheres nuk i flet, po mua, nuk do më flasësh?”, i rashë lehtë supeve, sikur po trokisja në një derë të mbyllur. Me prekjen time, supet e Katinës u ngritën dhe u ulën përsëri. “Unë jam më e mirë se tenxherja. Kam edhe veshë që të të dëgjoj, kam edhe shpirt që të ndiej dhembshuri për ty.”

Katina u kthye nga unë. Qëndruam ballë për ballë dhe u vështruam në sy. I buzëqesha shumë ëmbël dhe Katina më në fund ma hapi zemrën. Më foli me nostalgji për fshatin e saj, për të cilin nuk ndiente më dhembshuri pas gjithë këtyre viteve larg tij, por tani që ne po shkonim në Izmir, kaq afër vendlindjes së saj, dhimbja erdhi dhe e kaploi përsëri. Ma përshkroi nostalgjinë, si: “qindra specia djegës në gojën time”.

“Herë më vjen ndër mend një gjë, dhe herë një gjë tjetër, çdo kujtim, është një grusht tjetër me specia djegës.” Vështroi oborrin

nga dritarja e vogël dhe pyeti veten sesi do të ishte vallë sot oborri i saj i vogël, a do të kishte akoma në mes atë pemë të vjetër ulliri që kishte atëherë. “A i ujit njeri vallë lulet e mia?”, mendoi dhe këtë e shprehu me zë, a thua se ishte larguar jo më larg se dje.

Duke e pasur mendjen te shtëpia e saj, ajo mori tasin ku kishte barbunjat, e vendosi mes këmbëve dhe filloi t’i qëronte.

Mora karrigen, u ula përballë saj dhe zgjodha një barbunjë të madhe për ta qëruar të parën.

Po i qëronim barbunjat shumë ngadalë, sepse dukej që kishte shumë për të treguar. Më foli për të afërmit e saj, për shtëpinë dhe fshatin e saj. Më foli për vitet që kishte kaluar aty, vitet e fëmijërisë dhe të rinisë. Se si iku papritur, “një ditë të Zotit”, për të mos u kthyer më. “Hapën gropën nën këmbët e mia dhe pastaj do të kenë thënë se u hap toka e më përpiu. S’ka problem!”

“Pse u largove, Katina?”, e pyeta kur e kuptova se nuk kishte ndër mend të ma tregonte.

“Kjo le të jetë gjëja e vetme që nuk do të ta them, shpirt. Jam betuar që ta mbaj sekret.”

“Edhe prej meje?”, e pyeta pa të keq.

“Betimi është betim.”

Derisa ta mbaronim të gjithë tasin me barbunja, më erdhi frymëzimi, ashtu si vijnë zakonisht idetë pozitive, dhe i propozova: “Përse nuk u dërgon një letër, meqë do të shkojmë ne?”

Më vështroi e habitur.

“Ta marrin vesh që je gjallë, - i thashë, - dhe se nuk e ke harruar shtëpinë tënde, - teksa ia thosha, më dukej ide shumë e mirë. - Hajde Katina, - vazhdova e entuziazmuar, - mendoje sa mirë do të jetë të marrin një letër prej teje dhe të mësojnë se nuk u hap ndonjë gropë dhe të përpiu, siç besonin.”

Kështu, pra, si një ide që lindi vetvetiu, apo erdhi nga një barbunjë, vendosëm së bashku me Katinën, t’u dërgonim një letër.

I buzëqeshëm njëra-tjetrës të kënaqura, dhe unë u ngjita për të shkuar në sallon ku më kërkonin.

Te dera e kuzhinës u ndala se m'u kujtua diçka. U ktheva dhe e pashë që po shkonte te çezma për të larë barbunja. "Ejani, të shtrenjtat e mia, që t'ju laj, të gatujmë një gjellë të shijshme që të lëpijnë gishtat", e dëgjova t'u thoshte barbunjave.

I ngjita shkallët dy e nga dy dhe u futa në sallon e ndezur në fytyrë.

Evríkla në darkë, teksa më bënte kryqin në ballë - kështu më thoshte natën e mirë - m'u afrua te veshi dhe më pëshpëriti një sekret: "Katina nuk di shkrim e këndim".

Por Katina, më në fund, ia doli ta shkruante letrën e saj. Ma diktoi mua dhe e shkrova unë në vend të saj. Ecte lart e poshtë, thoshte një apo dy fraza, pastaj ndalonte menjëherë. "Jo, jo! - më thoshte. - Dua ta filloj ndryshe. Prishi ato që ke shkruar!"

"Katina, kështu si bën ti, së shpejti do të mbetemi pa letër", e qortova pakëz unë.

"Po ç'faj kam unë, bija ime? Thua se e kam bërë ndonjëherë dhe di si shkruhet një letër? - vazhdoi kështu derisa shpërtheu në lot. - Një herë më jepet dhe mua rasti t'u shkruaj njerëzve të mi, dhe nuk di çfarë t'u shkruaj." Fshehu fytyrën mes pëllëmbëve të duarve dhe filloi të qajë me dënësë.

Teksa përpiqeshim të gjenim një zgjidhje, na zuri nata.

"Katina, bëj gjoja sikur po u gatuan diçka për t'ua dërguar. Dhe gjatë kohës që gatuan, folu, sikur të jenë këtu e të dëgjojnë."

Në këtë mënyrë u shkrua dhe letra e Katinës. Një letër e gjatë, me fjalë zemre. E tillë ishte ajo letër. Dhe, kur e futa në zarf, shfrymë të dyja të lehtësuara.

U nisëm një ditë me shi, në drekë. Me një stuhi të zemëruar pranverore, ngaqë po afronte koha t'ia dorëzonte stafetën verës. Njerëzit vraponin në kalatat e portit me çadra në duar, apo të mbuluar me mushama, si të mundeshin.

Të tjerë u munduan të gjenin strehë nën tendat e pakta të kalatës, ku ishin grumbulluar ndërkohë shumë familje dhe hamej të lagur nga shiu. Që aty, në pritje që të pushonte stuhia, mbrapa një perdeje që formonte uji i shiut, vrojtonin ata të paktë gjakftohtë, që bënë ecejake nëpër shi, dhe qeshnin me pamjen komike të atyre që shkelnin pa dashje në pellgje të thella uji. Madje, nëse ndonjë i pafat rastiste të pengohej diku dhe të shtrihej sa gjerë e gjatë në rrugën gjithë ujëra, pësimi i tij komentohej nga ata me të qeshura të forta.

Në kuvertën e anijes, të mbrojtur nga një tendë e madhe, ndiqnim edhe ne së bashku me Evriklën, lëvizjet në mol dhe ngarkimin e anijes. Anëtarë të personelit të anijes, sapo shihnin që tenda formonte bark nga pesha e ujit të shiut, e godisnin me kujdes nga poshtë me shkopinj të gjatë, në mënyrë që të largohej uji i shumtë.

Ndiqja me sy Kallfaxhiun që, me fjalë dhe fishkëllima, u jepte udhëzime hamejve të ngarkonin bagazhet në anije. Hipte dhe zbriste nga anija me lehtësinë e një udhëtari me përvojë, të cilit nuk i bën përshtypje shiu. Ishte i pashëm - këtë e pranoja me krenari - megjithëse mbante mbi kokë një mushama të grisur.

Në strehën e madhe, pikërisht përballë vendit ku ishte ankoruar anija, e cila do të na çonte në Izmir, qëndronte nëna Kallfaxhi së

bashku me vëllezërit e mi. Herë pas here shikoja se si të dy djemtë ngrinin të dyja duart e tyre lart dhe më përshëndesnin. Ua ktheja përshëndetjen duke qëndruar në majë të gishtave, që të dallohesha më qartë mbrapa parmakëve të lartë të kuvertës.

Shikoja një herë Filipin dhe pastaj Fotin, që vinin pëllëmbët e duarve si hinkë përpara gojës, dhe më thoshin diçka me zë të lartë, por që nuk arrinte deri tek unë. Unë tundja kokën, bëja sikur i dëgjoja. Kur këmbëngulnin shumë, bëja gjoja sikur u flisja edhe unë duke vënë pëllëmbët para gojës, njësoj si ata. Atëherë pushonin për disa minuta të kënaqur.

Anija, e lagur së tepërmi dhe e rënduar nga ngarkesa, uji i shiut, udhëtarët dhe bagazhet e tyre, i ra tri herë sirenës dhe u nis për lundrim. U nis me ngadalë, sikur fillimisht donte që të çmpihej. Por edhe me këtë shpejtësi, pa dashje bëri që varkat më të vogla në port të lëkundeshin nga dallgët që u krijuan duke rrezikuar kështu të përplaseshin në mol. Vura dorën në gojë që të mos bërtisja. Evrikla bëri kryqin.

Njerëzit në kalata, duke shpërfillur shiun, dolën nga streha dhe filluan të përshëndesnin ata që po largoheshin me anije. Fishkëllimës së ngjirur të sirenës, iu përgjigj një potere zërash, thirrjesh dhe fjalësh, pa u dalluar njëra nga tjetra.

U thërrisja edhe unë njerëzve të mi të dashur që ishin në tokë, por zëri im, edhe në veshët e mi, u mbulua nga një fishkëllimë tjetër e sirenës së anijes. Pashë të afërmit e mi dhe çatinë e shtëpisë sonë, të zvogëloheshin e zvogëloheshin, derisa më humbën nga sytë.

Kapiten Agathangjellos ishte në moshën e tim ati. I shkurtër, me një bark të madh, si të një gruaje gati për të lindur. Në kokë, përveç vetullave të dendura, që gati i bashkoheshin, si dhe një tufë e dendur qimesh, që dilte nga secili prej veshëve të tij, nuk kishte asnjë qime floku. Por ia kalonte tim ati nga mustaqet. Kapiteni e

kishte zakon t'i përdridhte mustaqet sikur të ishin vida dhe jo t'i përkëdhelte, sikur të ishin një maçok.

Kur erdhi te salla e pritjes së anijes dhe na takoi, qëndroi në këmbë para tavolinës sonë, me këmbë gjysmë të hapura, siç i mbanin marinarët, filloi të diskutonte me tim atë lirshëm, si miq të vjetër, duke u tundur si varkë nën ritmin e lëkundjeve të anijes.

Para se të largohej, ma mori dorën dhe ma puthi, duke u përkulur pak dhe duke vazhduar të tundej. Ia ktheva me një buzëqeshje të trishtuar që nuk i përkiste koleksionit që kisha provuar me madam Simonën.

“Mos u trishtoni, zonjushë, - më tha duke më këshilluar. - Izmiri do t'jua shpërblejë.”

Agathangjello ishte një parashikues i aftë.

Kapiteni na kishte ftuar të hanim darkë së bashku te tavolina e tij. Më priti në këmbë dhe, duke u tundur, përsëri me një puthje dore tha: “Konstatoj me kënaqësi se zonjusha e bukur po e shijon udhëtimin”.

Gjatë kohës që po hanim, ai, duke dredhur mustaqet e tij të gjata, më tregonte histori për anije dhe marinarë. Histori që nuk i mora vesh, nëse i kishin ndodhur dikur atij personalisht, apo dhe ai i kishte me të dëgjuar.

E dëgjoja gojëhapur dhe me pirunin në dorë se si përshkruante stuhi deti dhe dallgë që lartësoheshin si male. E dëgjoja të fliste për Shën Nikollën, shenjtin mbrojtës të detarëve, i cili në momentet kritike shfaqej para syve të tyre dhe ledhatonte detin që të qetësohej. Për Shën Mërinë që shfaqej si ylber në qiell dhe i bekonte për të pasur udhëtim të mbarë.

“E keni parë edhe ju Shën Nikollën dhe Shën Mërinë, kapiten Agathangjello?”, e pyeta me admirim.

Tundi kokën në shenjë pohuese. “Madje më tepër se një herë, zonjushë Penelopë.”

“Dhe, si ishte?”, guxova të pyesja përsëri unë, e magjepsur.

“Si shpëtimi”, vetëm kaq më tha.

Kapiten Agathangjellos, duke qëndruar në këmbë, piu për shëndetin tonë dhe na tha se atë natë ishte shumë i lumtur. “Sepse ashtu si Odiseja, pasi udhëtova dhe kalova gjithë ato dete, sot pata kënaqësinë të takoj Penelopën.”

Të gjithë duartrokkitën dhe pinë për dollinë që ngriti kapiteni. Në veshët e mi, që ndieja se më dignin, dallohej e qeshura kumbuese e tim ati.

Duke marrë shkas nga fjalët e tij, një pasagjer u kthye dhe e uroi, tani që gjeti Penelopën: “Me këmbë të mbarë në tokë”.

Kapiten Agathangjellos i hodhi një vështrim të egër dhe i tha: “Unë në tokë? Kurrë! Edhe një herë të vetme, miku im, po të shohësh lindjen e diellit kur je në mes të detit, mjafton, e harron tokën, bëhesh një detar i përhershëm”.

E ktheu vështrimin nga ne dhe na pyeti nëse e kemi parë lindjen e diellit në det, por vështrimi i tij ishte ngulur vetëm tek unë.

Bëra një gjest që do të thoshte “jo”.

“Sa keq! Duhej! - tha. Dhe dukej sikur qortonte tim atë e jo mua. U kthye nga ai dhe e pyeti: - Pra, i dashur Kallfaxhi, a më jep leje që t’i tregoj nesër vajzës sate lindjen e diellit?”.

Kështu, pra, kaq thjesht dhe para gjithë atyre njerëzve, u bë marrëveshja. Ngritën gotat dhe pinë për faktin që unë do të shihja për herë të parë lindjen e diellit duke qenë në det.

Dhe me të vërtetë, siç na kishte thënë kapiteni, para se të gdhinte, një prej kamerierëve të anijes trokiti në derën e kabinës sonë. Hapa sytë dhe nga dritarja e kabinës pashë detin që nxinte. Mendova se kisha shumë kohë përpara derisa të lindte dielli, meqë nuk dallohej asnjë rreze drite, ashtu përgjumësh u ktheva në krahun tjetër, derisa kamerieri trokiti përsëri në derë, këtë radhë më me ngulm.

Më priu drejt urës së anijes.

Kapiten Agathangjello me dylbitë në sy vështronte horizontin që nxinte. Pa u kthyer që të më vështronte, i sigurt se isha unë ajo që isha futur, tha: “Shumë bukur, shumë bukur. Sot do të kemi një lindje dielli të mrekullueshme”.

Duke pritur lindjen e diellit, më tregonte instrumentet e anijes, më tepër duke m’i prezantuar, sesa duke më folur për funksionin që kryenin. Madje, më la ta mbaja për pak timonin prej druri të anijes, të cilin vetëm sa e preka.

“Tani po mbani në duart tuaja fatin e ne të gjithëve, - bëri shaka ai dhe më propozoi të mbështetesh te busulla. - Do të lodheni në këmbë duke pritur kur të shfaqet dielli”, tha.

Pas pak, ashtu siç isha me shpinën të kthyer nga deti, më shkundi lehtë dhe me sy të hapur shumë, sikur po shilte një demon deti, më tha me zë të ulët: “Penelopë, tani kthehuni”.

Sa i tha këto, mbi fron t’pruar Agimi u duk¹.

U ktheva dhe mbeta pa frymë. Vendosa duart në gjoks se e ndieja që zemra po më tradhtonte dhe po vraponte drejt diellit, e lidhur pas rrezeve të para të tij. Shumë larg, para syve të mi, në thellësi të pafundme, dielli, si një disk i zjarrtë, shfaqej me ngadalë nga brendësia e detit. Me madhështi, pa u nxituar, shtrinte ndriçimin e tij mbi shpinën e detit, i cili, i qetësuar, i falej atij. Deti na dërgonte valë të vogla të zjarrta, flakë të kuqe nga shkëlqimi i syve të diellit, që të përçonin mesazhin e hegjemonisë së tij.

E ndiqja ngjitjen e diellit në fronin e tij me sytë të skuqur, si vetë deti, e nënshtruar ndaj fuqisë së tij, deti i pafund dhe unë, që qëndroja në mes të tij. Lindi dita e re në një qetësi absolute, në një botë kaq primitive, apo kaq të zhvilluar, ku akoma nuk kishte tinguj.

¹ *Odiseja*, Kënga XII, vargjet 172-173. Përktheu Pashko Gjeçi.

U përkula dhe po shikoja nga ura e anijes në çdo drejtim të horizontit dhe ngado dalloja dritë edhe zjarr.

U ktheva në dhomën time e verbuar dhe gojëkyçur.

Kapiten Agathangjellos shënoi te vija anash faqes, në ditarin e kuvertës për ngjarjet e asaj dite: “Sot zonjusha Penelopë Kallfaxhi, udhëtare, pa nga ura e anijes për herë të parë në jetën e saj, lindjen e diellit në det”.

“Penelopë, shih! Ajo ndërtesë me harqe, ajo aty, është ndërtesa e famshme e Teatrit të Izmirit.”

Kishin filluar të dalloheshin ndërtesat e para të larta në mol.

Evrikla nuk kishte ardhur me ne te kuverta e anijes, i kishte mbetur hatri, ngaqë im atë ishte dorëzuar para lutjes sime që të shihja Izmirin një orë e më parë. “Do të mërzhitet dhe nuk do ta shohë fare”, u ankua ajo dhe kryqëzoi duart në gjoks.

Teksa hapnim derën për të dalë në kuvertë e dëgjonim që mërmëriste akoma:

E thirri n'çast mëndeshën Evrikle e i tha nja dy fjalë¹.

“Nga dhoma e hotelit, e sëmurë, mmm... do të ketë plot kohë në dispozicion për ta soditur!”

“Dhe kjo ndërtesa e madhe, Penelopë, në krah të djathtë të teatrit... ajo që sheh... ajo që të tregoj, ndiq gishtin tim tregues, është hoteli ynë. Hotel *Kraemer*.”

Hoteli *Kraemer* ishte hoteli më i madh dhe më i njohur i Izmirit. Ndohej afër molit, te *Ke*-ja e famshme, afër doganës dhe “shkallës” për anijet e vogla që shkonin në Kordhelio dhe në Gjosh Tepe. Ishte

¹ Po aty. Kënga XIX, vargu 21.

një ndërtesë e gjerë, trekatëshe, me njëmbëdhjetë dhoma në faqen ballore të çdo kati. Ishte një ndërtesë pozante, ashtu si edhe emri i hotelit: GRAND HOTEL KRAEMER PALACE.

Në sallën e pritjes, të binte menjëherë në sy llambadari gjigant në tavan, që reflektonte madje edhe në dritën e ditës, në dyshemenë prej mermeri që shkëlqente. Një sixhade e trashë, me nuanca të ndryshme të blusë edhe grisë, dhe një bordurë e gjerë ngjyrëvishnje në formën e simbolit të Greqisë së Lashtë, mbulonte, aq sa mundej, sipërfaqen e madhe të dyshemesë dhe përthithte zhurmat që bënin këpucët e klientëve kur ecnin.

Muret ishin të mbuluara me tapiceri, ngjyrë bojë qielli dhe argjendi. Piktura të ndryshme me peizazhe të natyrës ishin varur në rresht, në distancë të barabartë njëra nga tjetra. Mes tyre, abazhurë muri prej bronzi, që shkëlqenin nga të fërkuarit sikur të ishin prej floriri.

Në të majtë të hyrjes, ishin rreshtuar disa ndenjese dhe, në thellësi, kolltukë të vegjël, ishin vendosur në mënyrë të tillë që, nëpërmjet disa ndarësesh elegante, të formonin qoshe të rehatshme dhe ambiente intime.

Aty u ulëm me Evriklën sapo mbërritëm, duke pritur të sistemoheshin bagazhet. Freskia që mbizotëronte në sallën e madhe ishte po aq mikpritëse sa limonada e ftohtë që na ofruan.

Në të djathtë të katit përdhes ndodhej berraria e hotelit, që edhe ajo quhej *Kraemer*. Kishte emër të mirë dhe mblidhte shumë klientë, udhëtarë, por edhe banorë të Izmirit. Gjatë muajve të verës, berraria zhvendosej jashtë në mol. Në atë periudhë, gjatë gjithë faqes ballore të hotelit vendoseshin tavolina të vogla dhe karrige, duke lënë vetëm një hapësirë të ngushtë për hyrjen qendrore me harkun e saj të lartë. Tenda ofronte hije dhe freskinë e nevojshme që të mos shkriheshin shpejt akulloret.

Birraria kishte dy hyrje. Një nga ana e rrugës dhe një të brendshme, nga ana e sallës së pritjes të hotelit. Teksa pija limonadën, hidhja vështrime fshehurazi në brendësi të saj, duke admiruar burrat elegantë të Izmirit dhe gratë shumë të bukura të atij qyteti.

Të ulura në qoshen tonë për t'u çlodhur, së bashku me Evriklën shikonim njerëzit që lëviznin pareshtur. Veshjet e tyre, mënyrën fine të sjelljes, madje edhe fytyrat e tyre kishin një shprehje mirëqenieje, që nuk ekzistonte në Kerinia.

Kjo ishte përshtypja ime e dytë nga Izmiri, banorët e të cilit kishin arritur mirëqenie.

*N*atyrisht, përshtypjen e parë e krijova në portin e tij, kur mbërritëm. E trembur nga ajo mizëri njerëzish, mbahesha fort prej krahut të tim ati. Evrikla më mbante nga dora tjetër, që të mos më humbiste. Njerëz shkonin dhe vinin mes karrocave, disa të ngarkuara me bagazhe dhe të tjera me arka, që hapnin rrugën me vështirësi. Hamejtë, të cilët nga pesha e ngarkesës në kurriz, ecnin kaq të përkulur, saqë balli u arrinte te gjunjët, ecnin me hapa të shpejtë, të vegjël, duke përsëritur “*guarda, guarda*”, që njerëzit t’u hapnin rrugë.

Zërat në port arrinin te veshët tanë si një zë i vetëm, që fliste në mënyrë të përzier kryesisht dy gjuhë: greqisht dhe turqisht. Dalloja të folurën greqisht, ktheja kokën dhe dëgjoja turqisht. Gjithë ata njerëz i ngjanin një njeriu të vetëm me dy fytyra, secila prej të cilave kishte gjuhën e vet. Por edhe lagjen e vet, siç e zbulova më vonë duke shëtitur qytetin.

Pra, përshtypja ime e parë nga Izmiri, kur vura këmbën në tokë, ishte ajo e një qyteti shumëgjuhësh dhe shumëkulturor. Veç gjuhëve greke dhe turke që mbizotëronin, mund të dëgjoje edhe hebraisht, armenisht, italisht dhe frëngjisht. Kapelat europiane prej stofi për burra dhe kapelat prej kashte që ishin në modë, takoheshin dhe shoqëroheshin lirshëm në rrugë me festet tradicionale. Edhe veshjet tregonin prejardhjen e ndryshme të tyre.

*O i lojtur je, o nga shumë larg ke ardhur
ti, o i huaj, gjersa më pyet ku je.*

*Nuk është ky vend aq i panjohur n'botë,
po nam të madh ky ka në Lindje e n'Jug
në mjegull të Veriut, në fund të botës¹.*

Gjatë vizitës sime të parë aty, Izmiri i vitit 1913, më ofronte çdo ditë si një prestidigjitor edhe një zbulim të ri për qytetin dhe banorët e tij. Më magjepste me marifetet e tij duke nxjerrë nga kapela e tij një ditë pëllumba dhe lepuj, dhe ditën tjetër shami shumëngjyrëshe. Duke nxjerrë nga kapela e tij europiane prej kashte, një ditë shalle veneciane, ndërsa tjetrën, nga festja e tij turke, një shami koke për myslimanet.

Në asnjë vend të botës nuk ekzistonte qytet i ngjashëm me të që të kombinonte diturinë greke, ngathtësinë e ëmbël të Lindjes, shpirtin tregtar të hebrenjve, elegancën e Parisit, alegrinë franko-levantine, shpirtin punëtor të armenëve, temperamentin e fuqishëm europian. Të gjitha këto në një vend me bukuri të pakrahasueshme natyrore dhe trashëgimie historike.

“Evrikla, ndodhemi në qytetin më kozmopolit europian të Lindjes!”, pranova unë me zë të lartë, duke u përkulur jashtë dritares së dhomës të hotelit.

Dhe ndoshta në qytetin më të gëzueshëm.

Netëve më zinte gjumi te *Kraemer* e nanuritur nga tingujt e bisedave dhe të të qeshurave të klientëve në lokalet buzë detit në *Ke*. Të shtrira në krevat, qeshnim me Evriklën, duke thënë se banorët e Izmirit janë kaq të sjellshëm, saqë e gdhinin poshtë dritareve tona, që të nesërmen, kur të hapnim perdet, të na uronin “mirëmëngjesi”.

Mëngjeseve bashkoheshim me turmat e banorëve dhe ecnim edhe ne në *Ke*, si mike të zëna për krahu, duke lëvizur me nge në

¹ Po aty. Kënga XIII. Vargjet 290-294.

mes të njerëzve dhe duke i hapur rrugën karrocave që kalonin. Kur Evrikla lodhej, se nuk i pëlqente që të vërdallisej pa ndonjë qëllim të caktuar, uleshim në ndonjë prej lokaleve anës detit dhe pinim limonadë. Uleshim te *Poseidon*, te *Budapest*, te *Fotis* dhe te lokali im i preferuar *Cafe de Paris*.

Zakonisht rreth drekës te *Cafe de Paris* takonim zonjën Haritoglu - bashkëshorti i saj dhe im atë ishin miq të ngushtë që kur kishin quenë shokë shkollë në Izmir.

Kasandra Haritoglu na qeraste me çaj anglez, biskota franceze dhe ëmbëlsira tradicionale të Izmirit, që unë dhe Evrikla, sapo i provonim, shkëmbenim vështrime, ngaqë ishim në një mendje se ishin shumë më pak të shijshme se ato që na përgatiste Katina.

Pasditeve, çdo pasdite, takohesha me tim atë në hotel. Prisja ta takoja në sallën e pritjes ose të dëgjoja hapat e tij të rëndë nëpër shkallë.

E ndiqja pas në dhomën e tij për të më treguar se si e kishte kaluar ditën. Çfarë copash kishte parë, nëse kishte bërë porosi, cilat ngjyra ishin në modë dhe nëse kishte nënshkruar ndonjë marrëveshje të rëndësishme. Që atëherë në Kerinia, kur më kishte folur për udhëtimin tonë, më pëlqente ta dëgjoja të më fliste “burrërisht”. Por, kur im atë fliste për copat, transformohej gjithmonë në një fëmijë. Madje edhe kur qëllimisht e ndryshoja temën e bisedës dhe i flisja për çështje tregtare.

Duke keqinterpretuar dëshirën time që gëzohesha kur më fliste “burrërisht”, si interesim nga ana ime për tregtinë, Kallfaxhiu më mori me vete një mëngjes në takimet e tij të punës. Gjatë gjithë rrugës betohesha se do ta mbaja gojën kyçur. “Do të pi Ujin Memec, ke për të parë”, i thosha vetes.

Kështu ndodhi. Kalova një mëngjes të mrekullueshëm, si burrë, mes pëlhurave të cilat dija t’i peshoja me sy, e sigurt se as mua nuk mund të ma hidhte tregtari për cilësinë e tyre, që me shumë

zemërgjerësi do t'i klasifikoja si të cilësisë së dytë. Nuk më shpëtoi asnjë fjalë, asnjë pauzë mes tyre. Dalloja dhe përpiqesha të deshifroja madje edhe ndryshimin më të vogël të shprehjes së fytyrës të dy burrave. Përjetova kënaqësinë, sepse shkëmbimi tregtar ishte një kënaqësi dhe besoj edhe sot akoma, jo vetëm atëherë, se im atë ishte gjiganti im i padiskutueshëm, dhe se nuk kishte në botë tregtar më të mirë për allishverishe.

U deshën dy orë të mira, një kanë me Ujin Memec dhe pesë qerasje me llokume, derisa dy burrat më në fund shtrënguan duart për dy pëlhura të cilësisë mesatare dhe një të tretë, që unë e kisha gjykuar si të mrekullueshme, por im atë fillimisht dhe për habinë time të madhe, e kishte refuzuar “pa asnjë diskutim”. Ranë dakord për një çmim total, nga i cili as Foti nuk do ta kishte të vështirë të nxirrte fitime, dhe u larguam me shumë buzëqeshje reciproke dhe të velur nga llokumet.

Gjatë kthimit qeshja duke menduar se si do të reagonin vëllezërit kur të shtriheshim në tapetin me rombe dhe t'u tregojta këtë eksperiencë të mrekullueshme.

Ia tregova edhe tim ati mendimet e mia, qeshi edhe ai. Qeshi me të vërtetë, por shtoi: “Lërja tregtinë burrave, Penelopë. Nuk janë për gra këto punë. Tregtarë do të bëhen Filipi dhe Foti, jo ti. U sqaruam?”.

U sqaruam, dhe pothuajse - kështu u bë. Sepse kur mësohesh me diçka që të shijon, e kërkon.

Çdo buzëmbremje, pa asnjë përjashtim, para se të binte errësira e plotë, unë dhe Kallfaxhiu dilnim së bashku nga dera madhështore e hotelit *Kremer* dhe fillonim takimet tona shoqërore nëpër pritje dhe mbremje dëfrimi. Çdo ditë merrnim kaq shumë ftesa nga miq dhe bashkëpunëtorë të tim ati, sa që edhe të donim, nuk kishim mundësi t'i kënaqnim të gjithë.

Kallfaxhiu vendosi ta zgjasë qëndrimin tonë “që të mos u mbetej hatri miqve të dashur”. Por për mua, që siç thashë, e njihja gjigantin tim, ishte e qartë se e bëri ngaqë e shijonte njësoj si unë këtë udhëtim.

Daljet tona, si për të shkuar nëpër lokale, ashtu dhe nëpër shtëpi, ishin gëzim i madh për mua. Jeta mondane në Izmir nuk njihje pushim dhe, megjithëse nuk isha e mësuar ngaqë jeta jonë në Kerinia ishte e qetë, dukej që e kisha në gjak, më shkante kjo jetë, nuk lodhesha prej saj. Gjithçka për mua ishte e mrekullueshme. Si në përrallë. Njerëz të mrekullueshëm, në një qytet të mrekullueshëm.

Çdo natë kur kthehesha në hotel, i thosha Evriklës e entuziazmuar se natë më të bukur se kjo nuk kishte për të pasur.

“Çdo natë të njëjtat thua”, ma bënte Evrikla, e cila kishte filluar të mërziqej, ngaqë po vonoheshim të shkonim në Aidini.

Pas dy apo tri daljeve të para, e kisha farë të lehtë ta shoqëroja tim atë si një zonjë e re. Disa ditë në Izmir mjaftonin të piqej adoleshentja, që më kot përpiqej të joshte gurët në Kerinia.

Im atë ishte i pari që e vuri re këtë ndryshim dhe u befusua: “Gratë e Izmirit kanë edhe kusure. Të lutem, mos i imito në gjithçka”.

Me këtë frazë, fjalë për fjalë, më kishte uruar natën e mirë jashtë derës së dhomës sime, pasi kishim dalë bashkë atë mbrëmje. Më erdhi mirë se, që kur i njoha ato gra, u bënë ëndrra ime më e guximshme: të bëhesha dhe unë një ditë si gratë e Izmirit. Gratë që do t’ia shisnin shpirtin djallit për të joshur gurët me një vështrim, ishin shumë larg. Ditë të tëra udhëtimi me anije. Ose me aritmetikën e kapiten Agathangjellos, disa lindje dielli në det.

Një mëngjes më lajmëruan se po më priste zonja Haritoglu në sallën e pritjes.

Duke më kapur për supi, sikur të ishim vajza moshatare, më drejtoi për nga dalja. “Kam plane të mrekullueshme se si do ta kalojmë ditën sot”, më tha ajo.

U drejtuam për në Lagjen Franke. U futëm në një shtëpi që nuk dallonte nga shtëpitë e tjera përreth. Derisa sytë e mi të mësoheshin nga drita e rrugës në gjysmerrësirën e shtëpisë, në krye të shkallëve të brendshme kishte dalë një zonjë, hija e së cilës kishte mënyrën e të qëndruarit drejt të madam Simonës.

“Mirëdita, zonja, hyni!”, na uroi mirëseardhjen në frëngjisht hija e madam Simonës.

Zonja Haritoglu më shtyu lehtë që të ngjisja shkallët.

“Kjo, pra, është zonjusha që do ta bëjmë sot një parisiane të vogël, të vërtetë”, dëgjova e çuditur atë mesogrua të përsëriste urimin që unë i pata bërë madam Simonës.

“Kush ishte ajo magjistare që mund të parashikonte dëshirat e fshehta të vajzave të reja?” - pyesja e habitur veten teksa ngjitja shkallët.

U mënjanua që të më hapte rrugë të kaloja dhe, kur po futesha, nuk u besoja dot syve! Gjithë kati i sipërm i shtëpisë ishte shndërruar në një sallon të madh rrobaqepësie!

Aha! Për atë ditë, pra, ai qytet tepër i zgjuar dhe që nuk lodhej kurrë, i cili dinte të më bënte vazhdimisht surpriza, kishte ruajtur për mua një marifet të ri. Kërkoj dhe nxori nga rafti, revista mode franceze, si dhe fotografi mode në trajtë kartoline, të cilat zonja Kallfaxhi do t’i refuzonte me t’i parë, do t’i cilësonte si të guximshme dhe të papërshtatshme për një zonjushë modeste, e destinuar të jetonte në një qytet të vogël të Qipros.

Unë, gjithsesi, u hidhja vështrime shkarazi kartolinave, e verbuar nga ato që shihja dhe duke mos qenë në gjendje se çfarë të zgjidhja më parë. Thua se ato veshje të bukura u lëshuan nga lart si fishekzjarrë, por pa zhurmë, në një shpërthim ngjyrash dhe në ajër u hapën si parashuta fustanet prej mëndafshi origjinal, pastaj u ulën butësisht mbi duart e mia. Kaq ireale më dukej e gjitha kjo që përjetoja.

Me ndihmën e zonjës Haritoglu dhe ndërhyrjeve plot takt të përgjegjësës së shtëpisë së modës, zgjodha dhe provova veshje për paradite, pasdite dhe për darkë. Dy gratë dukeshin se po argëtoheshin. Zgjidhnin për mua kapela, nga një stivë ku ishin vendosur në formë piramide, dhe më ndihmonin që t'i provoja. Nga një kuti jo e thellë, që i ngjante një sirtari, zgjidhnin lule prej basme dhe me to më zbukuronin qafën dhe gjoksin, ndërkohë që një vajzë aty afër, ekspozonte mbi një banak dorashka, majtas ato për mbrëmje, dhe djathtas ato për përditë.

Lëvizja lart e poshtë, sikur të isha në pasarelë mode dhe e fshihja interesimin tim prej kokete duke bërë pyetje dhe komente për mënyrën se si më rrinin rrobat, apo se si qëndronin copat pas trupit. Vështroja veten në pasqyrën e madhe, me takt dhe me vështrime vjedhurazi, për të mos u kuptuar se doja që të sigurohesha se isha e bukur.

“Që të sigurohesh se dukesh e bukur me rrobat që provon, është pasqyra për këtë, e ëmbla ime!”, më tha zonja Haritoglu.

“Zonjusha është më femër se shumë prej klienteve të mia”, shtoi përgjegjësja e sallorit. “Sa mirë do të ishte të kisha kliente me feminitet të lindur si kjo zonjushë këtu!”

“Atëherë, e dashur, nuk kemi se çfarë të themi më tepër, veçse të urojmë që të gjejë një burrë të mirë nga Izmiri dhe ta mbajmë këtu”, iu përgjigj zonja Haritoglu dhe unë u skuqam më tepër se lulja e kuqe që mbaja në dorë.

Me po atë rreptësi që zgjidhja kur isha më e vogël copa nga duart e tim ati për veshjet e mia të ardhshme, zgjodha më në fund katër fustane. Fustanet më të bukura të botës.

Zonja Haritoglu i dha një letër vajzës që ndihmonte: “Dërgoju të lutem, në këtë hotel, së bashku me faturën”.

E vështrova shumë e habitur.

“Mos u shqetëso, jam marrë vesh me babanë tënd. Ai ma kërkoi”, më tha teksa më printe përsëri për te shkallët.

Dolëm në rrugë. Drita e fortë e ditës, si dhe ai zhurmërim, më zgjuan nga ëndrra.

“Ishte si një ëndërr, zonja Haritoglu”, pëshpërita duke vrapuar që ta arrija.

“Shumë herë jeta i ngjan një ëndrre, e dashura ime. Por menjëherë më pas, jeta mund të të bëhet një makth”, shtoi ajo.

Më kapi prej dore dhe përshkuam rrugën duke vrapuar. Kur arrita në trotuarin përballë, nuk e dija nëse gulçoja nga vrapimi që kisha bërë, apo nga tronditja që më kishin shkaktuar fjalët e saj.

Lëvizja lart e poshtë nëpër dhomë nga padurimi. Ia kisha përshkuar një mijë herë Evriklës fustanet, deri në hollësitë më të vogla. Por mezi po prisja sa t’ia tregojta. Kur, më në fund, pakoja arriti, e hapëm bashkë. Evrikla, si ata fëmijët e vegjël që hapin dhuratat e tyre, i nxirrte fustanet një e nga një dhe i vështronte me gojë hapur. Kisha një gëzim të dyfishtë teksa e shikoja që i admironte dhe i lavdëronte.

“Mbretërore! Mbretërore!”

Për çdo fustan ia shpjegoja Evriklës hollësitë, të cilat ia kisha përshkuar duke kërkuar me padurim të grumbulli i kapelave, i tregojta se cila kapelë i korrespondonte fustanit.

Natyrisht që i veshja njëra pas tjetrës, për t’i parë edhe të veshura. Zgjidhëm gërshetat dhe i provuam dhe me flokë të lëshuar. Më ndihmonte të vishesha dhe fjalët e ëmbla i rridhnin lumë. Përkëdhelte supet e mia të zhveshura, copat fine dhe thoshte e entuziazmuar: “Zoti im, më je rritur e më je bërë një grua e vogël. Kur u rrite, vajza ime? Kur e hodhe gjithë atë shtat, zogëz?”

Kisha ruajtur për në fund fustanin më të mirë, atë që vishej mbrëmjeve.

“Të të stolis si nuse kështu një ditë, amin Shën Mëria ime!”, vazhdonte monologu i saj.

Ma zgjati me kujdes kapelën, një beretë e vogël dhe shumë elegante, prej dantelle të bardhë shumë të dendur, të zbukuruar me lule të vogla, të rralla prej taftaje të bardhë. E vendosa si ma kapi dora nga nxitimi dhe u pashë në pasqyrë. Shkëlqejta nga lumturia. “Bam!”, i thashë pasqyrës. Prapa meje, sytë e Evriklës sime të dashur, ngjanin me dy yje të shndritshme.

Në atë moment erdhi im atë, për të parë çfarë kisha blerë. U fsheha pas perdes me vrap.

“Nuk do të m’i tregosh veshjet e tua të reja, Penelopë?”, më pyeti.

“Jo, - iu përgjigja unë me dinakëri, duke nxjerrë jashtë perdes vetëm fytyrën time, të mbuluar me një dantellë. - Do t’i shohësh një e nga një, kur t’u vijë dita.”

Ia shtrembëroi fytyrën Evriklës dhe doli nga dhoma. Jashtë në korridor dëgjonim të qeshurën e tij kumbuese teksa largohej.

Dita e nisjes sonë për në Aidini po afrohej, por letra e Katinës na digjte duart. Kishim pyetur dhe kishim mësuar se ku ndodhej fshati i Katinës, Narlikioi. Nga larg, kur ishim në Kerinia, Narlikioi ndodhej afër Izmirit. Por nga Izmiri ishte larg! U ndërgjegjësuam se nuk mund t'ia dilnim mbanë vetëm. Na duhej domosdoshmërisht ndihma e Kallfaxhiut.

“Babush, babush”, i thashë një ditë dhe e mbusha me puthje të shumta. I shpjegova problemin që kisha duke marrë poza dramatike dhe duke lëshuar edhe lot.

“Guxim i tepruar! Për atë Zot, Penelopë! - tha ai dhe u tërbua. - A e di ti ku bie Narlikioi? Për atë Zot! Dhe ajo Katina, e teproi!”

“Nuk ka faj Katina, baba. Unë e kam fajin. Unë ia propozova.”

“A, kështu qenka puna! Tani, po! Shkëlqyeshëm! - u mendua pak dhe pastaj më tha në mënyrë të prerë: - Nuk është nevoja të shkojmë atje. Lëre, do ta zgjidh unë. Do ta dërgoj me dikë letrën e Katinës.”

Më parakaloi dhe u drejtua për nga dera. Vrapova pas tij, e arrita dhe ndalova përpara tij. Qëndruam ballë për ballë. Peshuam njëri-tjetrin me sy. “Duhet ta dorëzohet vetë, - fola me ngadalë unë. - I premtova se letra do të mbërrijë e sigurt në duart e njerëzve të saj. Madje...”, fjala më ngeci në fyt.

Në fytyrën e tij dallova përsëri zemërimin. “Fol. Ka dhe më?”, më bërtiti me zërin e tij kumbues.

“... madje, - mora frymë thellë për të gjetur kurajën dhe për të vazhduar, - i premtova se kur të kthehem do t'ia përshkruaj shtëpinë e saj dhe të afërmit e saj.”

“... ta ndaloj! Dëgjon? Ta ndaloj! Thuaji që u sëmure dhe se letrën e dërguam me dikë, thuaji çfarë të duash. Por ajo që kërkon ti, nuk bëhet. U kuptuam?”

“Katina nuk di shkrim e këndim dhe letrën ma diktoi mua. E di se çfarë shkruan letra e saj dhe është e pamundur që ta flak. Veç kësaj, edhe iu betova, dhe betimin nuk duhet ta shkelim. A nuk më ke mësuar kështu? Atëherë në shtëpinë tonë, babush, të gjitha këto më dukeshin të lehta dhe të thjeshta. Unë ia dhashë këtë ide, dhe fajin nuk e ka askush tjetër. Nuk e dija. Më fal!”, ula kokën duke mos pasur asgjë tjetër për të shtuar.

E ndoqa për pak me sy teksa ecte lart e poshtë nëpër dhomë duke shfryrë. Hapa derën pa zhurmë dhe dola për ta lënë vetëm.

Kur isha në korridor, dëgjoja që më thirri pas derës së mbyllur: “Thuaji dados se e kërkoj unë”.

Im atë ia nxori inatin Evriklës fatkeqe.

U kthye në dhomë duke qarë pas një kohe që mua m’u duk sa një shekull. Gjysmë e fshehur pas perdes, pashë nga dritarja tim atë që u fut në një karrocë dhe u largua. Atë buzëmbremje iku vetëm, pa mua.

Dënimi për mua ishte i dyfishtë. Që nuk më mori me vete dhe që humba daljen e programuar për atë natë. Do të vizitoja shkollën e tij të vjetër, shkollën angleze të Sarejve, për të regjistruar që tani Filipin dhe Fotin si konviktorë të ardhshëm.

U zhvesha dhe u shtriva në krevat e mërziur. Gjumi mezi na zuri. Dëgjoja Evriklën në krevatin ngjitur që psherëtinte dhe shfrynte hundët fshehurazi nën jastëk, që të mos e dëgjoja.

Jashtë në rrugë, Izmiri vazhdonte të dëfrehej. Pa praninë tonë. Edhe vetë qyteti na dënonte. Futa edhe unë kokën poshtë jastëkut. Që të mos dëgjoja bisedat dhe të qeshurat që vinin nga jashtë. Por nuk mund t’i shmangia. Ato më shoqëronin edhe në gjumin tim të trazuar, duke më qortuar dhe duke më tallur deri në mëngjes për guximin tim të tepruar.

Të pasnesërmen, para se të agonte mirë, u nisëm me karrocë për në Burnova, dhe si bagazh kishim vetëm letrën e Katinës.

Qyteza e Burnovës ishte një prej lagjeve më popullore periferike të Izmirit, tetë kilometra në verilindje. Para saj shtrihej një fushë e madhe dhe e begatë që përfundonte në rrëzë të malit Sipillo. Megjithëse ishte fund pranvere, dhe vera pothuajse kishte mbërritur fshehurazi, shumë prej shtëpive ngjanin sikur vazhdonin gjumin dimëror. Ishin shtëpi verimi, me grilat e dritareve të mbyllura dhe tavolinat e karriget e kopshteve të mbledhura.

Me të mbërritur në Burnova, pasi kishim shijuar gjatë rrugës peizazhin dhe aromat e luleve, u ulëm në një lokal në qendër të asaj qyteze. Ishte një kafene e lyer me ngjyrë blu, kurse hekurat e dritareve, të lyer shkel e shko, me ngjyrë të verdhë. Lagështira e dimrit e kishte zhveshur në disa vende shtresën e bojës dhe poshtë saj dallohej ngjyra e mëparshme bojë qielli. Një ushtri e tërë macesh kishin zënë secila nga një kafaz të përmbysur, shtruar me copa rreckash. Vetëm njëra, më e shëndosha, ndoshta valide hanëmi, shijonte madhështinë që i jepte një karrige prej kashte.

Macet nuk lëvizën kur ne u futëm në lokal, as kur Kallfaxhiu fishkëlleu që të vinte dikush për të marrë porosinë.

Nga aty ku ishim ulur, nga dera e pasme e hapur e lokalit, shikonim malin Sipillo. Përmes oborreve, shtëpive të fshatit dhe shtëpive të verimit, vështronim me dëshpërim rrugën që u ngjitej shpateve të malit të Katinës. Në Narlikioi.

Një grup kalorësish po zbrisnin me nge nga mali dhe po u afroreshin shtëpive, duke ndjekur shtratin e përroit të Burnovës. E kishin marrë shtruar. Ne ndiqnim rrugëtimin e tyre, që gjarpëronte te shtegu. Befas i humbëm nga sytë, mbrapa plantacioneve me ullinj dhe pemëve frutore, por pastaj u rishfaqën pas vreshtave. Edhe kur nuk mund t'i shikonim, prezencën e tyre e tradhtonin të lehurat e qenit që i ndiqte. Dëgjonim të lehurat që sa vinin dhe afroreshin.

Vapa e verës, që kishte mbërritur herët, na kishte gozhduar te karriget e lokalit të lyer me ngjyrë blu. Letra e Katinës më digjte në dorë.

Kur u afruan mjaftueshëm, im atë u nis drejt tyre duke bërë gjeste me duar. Filloi të bisedojë me ta aty në këmbë. Bile në një moment e pamë që u kthye dhe bëri shenjë nga ne, kalorësit vështruan në drejtimin tonë. Por nga brendësia e lokalit ku ndodheshim, nuk mund të dallonim fytyrat e tyre.

Kallfaxhiu u kthye në lokal dhe ne prisnim që, pas një bisede kaq të gjatë, çështja e vajtjes sonë në fshat do të ishte rregulluar. Por im atë fshiu buzët me dorë, fërkoj unazën pas pantallonave dhe nuk tha ato që ne dëshironim të dëgjonim. “Gjahtarët vijnë nga Narlikioi. Thonë se rruga kalohet me vështirësi, ngaqë mbrëmë ka rënë shi dhe ka baltë. Vetëm kuajt ose mushkat mund të kalojnë.”

E dëgjonim dhe shprehja që kishin marrë fytyrat tona ishte për t’u mëshiruar. Evrikla, që e kishte marrë veten pas udhëtimit të mëngjesit me karrocë, u zbardh përsëri në fytyrë.

“Nejse, - vazhdoi im atë, të cilit nuk i pëlqenin fjalët e shumta kur fliste ‘burrërisht’. - Ekziston vetëm një mënyrë. Pritet të mbërrijë shumë shpejt në Burnovë një person që ka mushka dhe që bën rrugën e Narlikioit. Do ta çojë ai letrën. U sqarua?”

Tunda kokën në shenjë pohuese. Evrikla pranë meje, belbëzoi një “po”. Ishte e qartë se nuk kishte zgjidhje tjetër. Më mirë kështu, sesa fare, u ngushëllova unë.

Dhe, me të vërtetë, pas pak erdhi në lokal pronari i mushkave, një burrë zeshkan nga koka te këmbët. Mbante në këmbë opinga prej lëkure deleje dhe kishte mbështjellë pulpat e tij me rreca të pista. Në mes kishte mbështjellë, dy apo tri herë, një brez të gjerë në ngjyrë të kuqe, i cili e ndante më dysh atë pamjen e tij zeshkane.

Në secilën prej anëve të samarit të mushkës së tij të sflitur, varej nga një shportë e madhe. Shportat, megjithëse ishin lidhur fort, ishin kthyer aq shumë anash, sa ishin gati ta zbraznin përmbajtjen e

tyre në pengesën e parë, të shtyra në atë pozicion nga barku i fryrë i mushkës. Bishtin e mushkës e stolisnin shirita shumëngjyrësh, a thua se mushka ishte një kalë krenar.

Im atë i dha atij udhëzimet përkatëse, ndërsa unë ia dhashë letrën. Ramë dakord që ta prisnim këtu kur të kthehej, që të na tregonte si kishte kaluar.

Duke dyshuar se mos tallej me ne dhe na gënjente se gjoja e dorëzoi letrën, unë i kërkova që të na tregonte hollësisht. “Ah, po, - shtova unë në momentin e fundit, - dua edhe një lule nga kopshti i saj.” Pemën e ullirit në oborr nuk e zura në gojë, sepse mund të mos ekzistonte pas kaq vitesh.

Orët kalonin shumë ngadalë. Im atë fjeti te karrigia e vet, ndërsa macet në kafazet e tyre. Gërhitja e tij ndërpriste mendimet tona. Shkëmbenim vështrime me Evriklën, që të merrnim kurajë nga njëra-tjetra. Dhe prisnim... dhe prisnim...

Koha ecte mbrapsht. Duhej të caktonim dhe një orë për kthimin tonë në Izmir. Kur më në fund ai u shfaq, i lyer me baltë deri në gju, kohës dhe durimit tonë po i vinte fundi. Kutërbonte erë raki. U justifikua se e kishin qerasur të afërmit e gruas për lajmet e mira.

Ne vareshim nga goja e tij.

“Kishin një oborr të vogël, me shumë lule dhe një ulli të vjetër në mes të tij.”

Shfrymë të lehtësuara. Im atë, afër meje, fërkonte mustaqet dhe buzëqeshte.

Në vazhdim na foli për familjen e Katinës, duke i dhënë rëndësi gjërave që e kishin qerasur. “Si sulltan më pritën”, ia bëri.

“Po tjetër?”, e ndërpreva unë, se po harxhonte shumë kohë duke folur për qerasjet.

“Kam edhe diçka për të thënë, dhe mbaruam. Në momentin kur mora mushkën dhe po nisesha për t’u kthyer, erdhi drejt meje një

grua e moshuar, më kapi nga këmba dhe më tha: ‘I thoni Katinës se Jordani vdiq.’”

E vështruam të gjithë të habitur.

“Pikërisht kështu më tha. Këto janë fjalët e saj. ‘I thoni Katinës se Jordani vdiq.’”

“Po gjë tjetër nuk tha, o i uruar?”, këmbënguli im atë që t’i kujtohej ndonjë gjë.

“Asgjë tjetër. Këtë më tha dhe nxitoi të futej përsëri në shtëpi së bashku me të tjerët.”

Ai u ngrit që të largohej. Vajti në drejtim të derës dhe u kthye. Nxori nga xhepi i jelekut të tij të zi një degë ku kishte çelur një mëllage e kuqe. “Lulja jote, bija ime”, tha dhe ma zgjati.

Gjatë gjithë rrugës së kthimit, nga Burnova në Izmir, askush nga ne nuk foli. Evrikla dhe unë po përpiqeshim të sillnim ndër mend nëse Katina na kishte folur ndonjëherë për njëfarë Jordani. Të kishte vëlla me emrin Jordan? Apo ndonjë nip? Ndoshta ndonjë i afërm shumë i dashur i saj?

Me këto pyetje dhe me mëllagën e kuqe, u kthyem në rehatinë e jetës së Izmirit. Fjetëm duke fantazuar dhe në gjumë, historira për njëfarë Jordan, që vdiq.

Nuk arritëm të çlodheshim nga udhëtimi ynë në Burnova, dhe të martën e parë u nisëm me tren për në Aidini. Parashikohej të niseshim në orën 09:45 të mëngjesit dhe të mbërrinim në Aidini në orën 19:20 të darkës.

Ndryshe nga unë, as treni dhe as mizat në të, nuk nxitonin për të arritur në destinacion. Në stacionet e ndërmjetme treni ndalonte duke pritur me nge që të zbrisnin udhëtarët me shportat, me bohçet dhe tufat e zogjve që kakarisnin fatin e tyre, duke pritur të urinonin ata që do të vazhdonin udhëtimin, dhe ne të tjerët të çmpiheshim me trupat të varur jashtë dritareve.

Në çdo stacion, një tufë shitësish ambulantë rrethonin si miza trenin që kishte ndaluar. Nga dritarja e hapur e vagonit, futeshin brenda duar të palara që mbanin stafidhe, pastel, akullore gati të shkrira dhe limonada si ujë.

Gjatë udhëtimit, tronditjet e trenit nuk i bezdisnin mizat, të cilat uleshin kudo ku nuk kishte një dorë njeriu për t'i dëbuar. Unë i dëboja me freskoren time, e skuqur deri te veshët. Nga padurimi që të mbërrija në Aidini dhe nga ato që dëgjoja.

Kallfaxhiu nuk dukej se mezi priste të arrinim. Kishte zënë dy vende, ishte shtrirë sa gjerë e gjatë dhe kishte filluar monologun e tij. Evrikla, herë pas here, i aprovonte ato që thoshte, ose e ndihmonte për të kujtuar diçka. Gjatë gjithë kohës tjetër dëgjonte me kujdes ato që thoshte dhe tundte kokën nën ritmin e lëkundjeve të trenit. Në pikat nevralgjike të tregimit, ngrinte vetullat dhe shfrynte. Ose mblidhte buzët. Por kur fjala

binte te gjyshja ime, nëna e babait tim, shtrembëronte gojën dhe thartonte fytyrën.

Im atë nuk nxitohej. E dinte se kishte në dispozicion gjithë kohën që na duhej derisa të mbërrinim. Dhe e dinte se i duhej shumë kohë që të më tregonte historinë e prindërve të mi. Dinte gjithashtu se mua më duhej shumë kohë për ta dëgjuar. Dhe po aq kohë që unë të futesha në brendësi të historisë sime.

Filloi duke treguar se si e njohu tim atë, babanë tim biologjik.

“Tregtonte tapete dhe sixhade në Anadoll. Shkonte tek ato fshatra që endnin këto sixhade dhe i blinte. I transportonte drejt porteve të ngarkuara nëpër deve, ose për në Izmir, ose në Ajvali, dhe prej andej i dërgonte me anije në Marsejë. Pastaj kthehej dhe drejtohej në brendësi të vendit, në thellësi të Turqisë. Madje thoshte se tri herë kishte arritur deri në kufijtë e Persisë.

Shkonte shumë rrallë në shtëpinë e tij. Ishte nga Aidini. Aty jetonte me nënën e tij. Ishte fëmija i saj i vetëm dhe e kishte si ujët e pakët.

Unë u njoha me të afër Eski Sehir-it. Gjuetia për fitime të majme më kishte çuar te burimi i mëndafshit cilësor. Unë nuk isha i mësuar si ai. Isha mësuar të punoja në Qipron tim të bukur, në dyqanin tim të rehatshëm dhe në këtë vend të thellë të Turqisë kisha frikë.

Ç’kërkoj unë këtu, si u tregova kaq budalla dhe mbërrita deri këtu, - qortoja veten, - ia vlen që të vë kokën në rrezik për pak fitim? Këto gjëra mendoja dhe shpresën e mbaja tek arma ime. E kisha futur te poturet dhe vazhdimisht e shtrëngoja. Zot na ruaj, - thosha me vete, - o Shën Mëri, ç’kërkoj këtu? Befas dëgjova: ‘Nëse nuk dëshiron ta përdorësh, mos e shtrëngo!’. O Shën Mëri, - bëra kryqin dhe u ktheva andej nga vinte zëri. ‘As kryqin mos e bëj, nëse nuk do që ta përdorësh!’ - i tillë ishte yt atë. Guximtar, ia thoshte zemra.

Ishte mjeshtër në tregtinë e sixhadeve Harallambi. Copat i ishin bërë mikrob, ashtu si dhe mua. Jepi një tapet të bukur, të thurur

mjeshtërisht, dhe merri shpirtin - i tillë ishte ai. Edhe në këtë pikë puqeshim. E ngjishte fytyrën te sixhadeja, ishte miop, që ta dish, dhe fillonte e numëronte nyjat duke i prekur me dorë. I kruante butë me thonjtë e tij. Pastaj ledhatonte thekët. Dëgjonte zhurmën karakteristike që bënte mëndafshi. Mos më vështro vëngër. Ka njerëz, krimba mëndafshi do t'i quaja, që kanë dhuntinë të dëgjojnë fijen e mëndafshit. Më dëgjo mua.

Ai kishte endësit e tij të përhershëm të sixhadeve. Hynte në shtëpitë e tyre, në ato shtëpi përdhese fshati, ku vështirë se hynte ndonjë burrë. Duhet të dish që sixhadetë endeshin nga gratë e shtëpisë. Endëset ishin gratë e familjes. Prandaj në këto fshatra, lindja e fëmijëve femra ishte një bekim, sepse ishin fuqi punëtore. Dhe fuqia punëtore është pronë. Mbaje shënim këtë që po të them, se yt atë futej në shtëpitë e tyre dhe se ato duar, ajo fuqi punëtore, ishte pronë, sepse do t'i rikthehemi, kur të flasim për nënën tënde.

Siç e kuptoni dhe vetë, iu ngjita Harallambit si qeni të zotit. I njihnte mirë vendet. ‘Mos u shtri aty, - më tha një natë që bujtëm në një han, - ka pleshta dhe disa akrepa kaq të mëdhenj! Eja me mua në stallë.’

Në stallë ishte errësirë pus. Nuk kishte as pishtarë dhe dritë të mjaftueshme. Nuk sheh matanë hundës sate. Njeriu, kur mbetet vetëm, fillon e flet. I flet vetes së tij? I flet atij që nuk e sheh? Gjithsesi, flet.

Gjithsesi, yt atë, mua më foli atë natë në errësirë”, - vazhdoi Kallfaxhiu.

“Tregoji Penelopës se si e pa për herë të parë në fshatin e sixhadeve nënën e saj dhe shtangu nga bukuria e saj.”

“Me ngadalë, Evrikla, mos u nxito. Kemi akoma shumë rrugë për të bërë.”

“Po, imzot, por tregoja gjërat e bukura.”

“E mirë, kalojmë te gjërat e bukura. Që nuk janë dhe aq të bukura, moj Evrikla, e si i quan të bukura.

E, pra, njëherë yt atë futet në një shtëpi të vogël përdhese për të parë sixhadenë që po endnin gratë, e ç'të shihte? Ç'të shihte? Midis plakave dhe vajzave të vogla, mbi sixhade ishte përkulur një vajzë e re në moshë dhe po endte! Ishte ulur si ulen gratë turke, kishte shtrirë përreth saj fustanin e gjatë dhe, si më thoshte yt atë, ishte shumë e bukur, qafa e saj ngjante si bishti i gjethes. Si një lule ishte ajo vajzë, - më thoshte. Dhe siç ishte duke endur, thua se e kuptoi, apo kështu ishte shkruar, ngriti kokën për të hedhur një vështrim vjedhurazi. Por ç'sy ishin ata! Ç'zjarr ndezën te Harallambi ata sy! Aman, *yavrum!*

Jep porosinë, që thua ti, dua kaq e kaq sixhade, në këtë e në atë model, u thotë që do të kthehet prapë në pranverë për t'i marrë, dhe ngrihet, ikën. Ikën, por si ikën! Zemra i mbeti aty, e skllavëroi nëna jote. 'Oh, aman! Oh, aman!' - ia bënte deri në pranverë.

Në pranverë u kthye, këtë herë, për të mirë a për të keq, rroi mjekrën. E gjeti duke endur. Kështu e kalonin kohën gratë. Endnin nga mëngjesi deri në darkë. Vashëza ishte ulur pranë dritares që drita e diellit të binte në duart e saj. Ashtu si ishte e përkulur, drita i ndriçonte fytyrën. Dhe, teksa Harallambi po e vështronte, për të parë gjoja se si endte, ajo ngre sytë dhe e vështron. Oh, oh, oh. Zemra i rrahu fort përsëri.

Kur të vinte herën tjetër, e kishte vendosur, nuk mund ta shtynte më. 'Do ta marr atë vajzë për grua, - më tha. - Do ta marr hipur mbi kalë deri në Aidini dhe nëse nuk e bëj, mos më thënçin Harallamb.' S'kaloi shumë kohë dhe takoi të atin e saj. 'I shkreti unë, ç'më gjeti, - filloi e i qahet ai, - gjatë dimrit humbën jetën dy endëse dhe nuk arrita të ta mbaroj porosinë.' Në ato momente babait tënd as nuk i binte ndër mend për porosinë. Tjetër gjë e digjte. Me atë hall që kishte, se kishte një sixhade më shumë, a një më pak, kujt i interesonte? Kur dëgjoji se tjetri kishte humbur dy endëse, u çmend, se mos ndoshta njëra qe ajo për të cilën interesohej.

‘I mjeri ti, ç’ të ka gjetur!’ - i shkoi pas avazit dhe Harallambi. ‘Biri im, - i tha ai dhe vazhdonte të qante, - as im bir nuk do të më ngushëllonte kështu, humba gjyshen dhe një teze të moshuar.’

Në atë moment, Harallambi gjeti rastin dhe ia plasi, duke i thënë se kishte ardhur për të marrë sixhadetë, por edhe vajzën e tij për grua. ‘Pa prit pak, - u kthjellua vjehrrri i ardhshëm, - kjo është serioze dhe duhet diskutuar.’ U bënë përpjekje të forta për nënën tënde, pse kaq lehtë do ta merrte?

‘Po, more bir, po, - i tha gjyshi yt, - por ti kërkon të më marrësh dy duart më të shkathëta që kam.’

‘Ashtu është, por do të kesh një gojë më pak për të ushqyer’, iu përgjigj yt atë.

Gjyshi yt dukej që ishte i rrahur me vaj e uthull në këto punë. Babai yt e pikasi këtë gjë dhe nuk e la rastin t’i shpëtonte nga duart.

‘Shto këtu dhe gjyshen tënde dhe tezen që humbe, na u bënë tri. Tri gojë më pak për të ushqyer!’, vazhdoi yt atë.

‘Po more bir, po me kë do të mbetem unë? Me nënën, me gruan dhe ato pesë çupëlina? Vaj medet për mua!’

‘Nëse kërkon dëmshpërblim për vajzën që do të të ikë, çfarë të të them dhe unë, mos më jep pajë.’

‘A, këtu do të prishemi! Pa pajë? Si të dal unë para njerëzve?’

‘Ç’ të të them dhe unë. Më jep pajë sa për të thënë, dhe unë nuk do të ndihem.’

‘Jo, jo, kjo nuk bëhet! Do t’i jap pajën më të mirë. E merr dot me mend se çfarë kam ruajtur për të? Një vresht. Vera që nxjerr ai vresht, ringjall dhe të vdekurit.’

‘Ta pish për shëndetin tonë, xhaxha. Se mos do të jemi këtu që ta shijojmë!’

Pa shtrënguar mirë duart dhëndër e vjehërr, dhe Harallambi i gjeti të gjitha gati. Gjysmën e sixhadeve që kishte porositur, aq sa

kishin përfunduar, të ngarkuara te deveja dhe, pas devesë, lidhur një mushkë mbi të cilën kishte hipur nusja.

Kështu, pra, Harallambi iku me nënën tënde nuse për ta çuar në Aidini, që të bënte dasmë. Mbaronin një rrugë e fillonin një tjetër dhe yt atë vazhdimisht kthente kokën mbrapa, e vështronte në sy dhe nuk kishte të ngopur. I zuri nata në rrugë dhe gjetën një han. ‘Këtu do të kalojmë natën, nesër, dashtë Zoti, vazhdojmë rrugën tonë’, i thotë.

Në atë moment vë re se sytë e vajzës ishin mbushur me lot. ‘Mos ki frikë, - i thotë, - nuk do të të prek. Unë do të fle në oborr.’ Por sytë e saj nuk shteronin nga lotët, që i rridhnin faqeve. ‘Nga se ke frikë? Do të kujdesem për ty. Që nga oborri do të të ruaj.’ Dhe e zë për krahu, e zbret nga mushka dhe i drejtohet hanit. Dhe, çfarë të shohë? Nuk mund ta imagjinojë! Çfarë pa i uruari? Njëra këmbë e vajzës ishte më e shkurtër nga tjetra. Vajza ecte duke u anuar nga dy krahët.

I iku zëri. E la në dhomë dhe mbylli derën pas vetes. E kaloi natën në oborr duke u grindur me veten. I binte kokës me grushte për këtë mbrapshti, nuk dinte ç’të bënte. Nuk mund ta besonte! E kishte gjithë inatin me vjehrrin e tij dinak që ia kishte fshehur këtë të metë të së bijës, që i fali dhe pajën së bashku me vreshtin, që ai të pinte për shëndetin e çiftit. E kishte hallin sesi do ta priste këtë gjë e ëma e tij në Aidini, e cila i kishte ngrënë veshët, se donte nuse për ta pirë në kupë! Hante veten me dhëmbë, mallkonte fatin e tij, mallkonte djaj e Perëndi dhe, sa vendoste që gjënë e parë që do të bënte të nesërmen, do të ishte të kthehej nga kishte ardhur dhe ta kthente nusen, ndër mend i vinin sytë e saj të mbushur me lot.

Kjo i rëndonte më tepër se betimi që kishte bërë, që mos t’i thoshin më Harallamb, nëse nuk do ta çonte nuse në Aidini. Ata sy të mbushur me lot. Dhe vuante edhe vetë, kaq shumë e ndiente dhimbjen e saj. E kuptoi se vajza kur ishte mbi mushkë nuk qante, ngaqë kishte frikë, ata lot ishin lot lutjeje. Ose qante për fatin e saj

të paracaktuar, të cilit nuk mund t'i shmangej. Ngaqë e dinte se nuk mund të qëndronte një jetë të tërë hipur mbi mushkë.”

Në këtë moment Kallfaxhiu bëri një pauzë dhe tërhoqi hundët.

“Kur agoi, e mori përsëri për krahu dhe, ashtu duke çaluar, e çoi përsëri te mushka. Vazhdoi rrugën drejt dhe nuk u kthye mbrapsht. Vajza e kuptoi që nuk do ta kthente mbrapsht dhe se do ta merrte për grua, pra, nuk kishte ndryshuar mendje tani që e pa se ishte çalamane, dhe ia shkrepiti të qarit. Po këtë herë veçse qante nga mirënjohja.

Këto gjëra më tregoi yt atë, atë natë te stalla. Kur arritën te shtëpia e tij në Aidini, ashtu siç ia kishte frikën, plasi sherri. Nëna e tij bërtiste se i solli nuse çalamane dhe kurrë nuk e deshi nusen e të birit.”

Në këtë pikë, fytyra e Evriklës ishte shtrembëruar krejtësisht.

“‘E mirë, flori ishte nëna ime, por shtrigë’, kështu ma përshkroi nënën e tij yt atë, i cili e donte shumë, por nuk e duronte dot. Më tha se ia bëri ferr jetën gruas së vet. E shoqja, sipas nënës së tij, nuk kishte asgjë të mirë.

Nëna jote, le të themi, ishte mësuar të hante shtruar në dysheme, duke e marrë ushqimin nga pjata me dorë, siç e kishin zakon turqit. Ndërsa gjyshja jote hante me lugë në tavolinë. ‘Ta mbash me shëndet, bir’, ia hante shpirtin me grindje, ngaqë gruaja e vet hante me duar. ‘Ndërsa asaj, nënë, i duket e çuditshme që ti ha me lugë’, i përgjigjej ai. ‘E pse habitet? Ngaqë ha ashtu si duhet?’, ia kthente plaka.”

“Hëm, pa thuaj dhe atë tjetrën, që kur ikte Harallambi për punë, e linte Angjelonë të vdiste urie!” , ndërhyri Evrikla.

“Kështu duket, se e linte edhe nënën tënde të uritur. Sepse nusja mund të hante me duar, por e ndiente dhe nuk fillonte të hante pa filluar më parë vjehrra e saj, dhe e linte ushqimin, sapo plaka e linte lugën. Kështu, vjehrra e pa të arsyeshme që kur mungonte Harallambi, të hante fshehurazi, në mënyrë që kur të vinte koha për të ngrënë, të

hante dy-tri kafshata, aq sa nusja të mos vdiste urie, dhe pastaj shtirej sikur ishte ngopur dhe linte lugën.”

“Pa trego se si i mbyllte me çelës ushqimet në dollap dhe i numëronte, në mënyrë që ajo e shkretë të mos gjente asgjë në kuzhinë dhe të hante!”, u hodh e tha Evrikla.

“Dhe, për sa kohë që ti Penelopë nuk po lindje, rrethanat i jepnin të drejtë plakës. Shtrembaluqe, çalamane dhe shterpë! Yt atë i kishte kuptuar padrejtësitë, i dhimbsej nëna jote, por çfarë të bënte? A mundej të mos shkonte për punë? Si mund të jetonin?”

“Kallfaxhi, - më tregoi atë natë në errësi, - do të të them diçka që vetëm ti mund të më kuptosh. Them ta lë tregtinë e sixhadeve dhe të filloj tregtinë me kripërat, që të mos largohem nga Aidini.””

Po i afrohem Aidinit, dhe jam në gjendje të të kuptoj edhe unë, baba.

“A mund ta lija dhe të mos e bëja mik një burrë të tillë? - vazhdoi Kallfaxhiu. - Dhe si i sjell fati ndonjëherë gjërat, i kthen andej, i kthen këtej dhe, në fund, i sjell gjërat si do vetë... ditën tjetër, kur u ngritëm nga gjumi në stallë, u nisëm për punët tona. Unë në kërkim të copave të mëndafshta, të endura me cilësi dhe yt atë në kërkim të sixhadeve prej mëndafshi të cilësisë më të mirë.

Siç ishim duke ecur, mua më shkeli këmba në boshllëk dhe më doli kaviija. Harallambi u përkultë ma lidhte, teksa ishte ulur në gjunjë, doli nga barërat një nepërkë dhe e pickoi në këmbë. E shtriva me shumë vështirësi mbi gurë dhe ia lidha këmbën në pjesën e sipërme me brezin tim. Pastaj u përkula, ia çava mishin me thikë dhe fillova t’ia thithja gjakun bashkë me helmin. Ia kafshoja mishin me dhëmbë, më keq se nepërka, në mënyrë që të grumbullohej gjaku i keq, ia thithja plagën dhe pështyja.

Pastaj e mora hopa, që të ktheheshim te hani. Po si t’ia bëja, kur vetë nuk mund ta shkelja këmbën? Pas shumë përpjekjesh duke

çaluar, arritëm në han. Harallambi ndërkohë, kishte filluar të ënjtej dhe të fliste përçart.

E shtrimë në një vend të freskët dhe fillova t'ia fërkoja plagën me qepë të thatë. E fërkoja, e fërkoja, por ai vazhdonte të ënjtej, nga maja e kokës deri në fund të këmbëve. Kaq shumë ishte ënjtur, saqë lëkura filloi t'i çahet dhe ishte bërë si luspat e gjarprit. Kishe frikë ta shikoje. Kishte filluar të merrte frymë me vështirësi. E ënjtura e madhe te qafa po ia bllokonte rrugët e frymëmarrjes. E vështroja i tmerruar duke menduar se mund ta humbisja mikun tim. Kujtoja se do të pëlcaste. Po bëhesha gati t'ia çaja me thikë lëkurën te gryka, në mënyrë që të kishte mundësi t'i mbushte mushkëritë me frymë. I rrija sipër kokës me thikën në dorë dhe dridhesha. 'Mos! Mos! - më vështronte me sy të zgurdulluar. - Angjeloja! Angjeloja!'

Gjithë ditën luftonte të mbahej në jetë për Angjelonë e tij. Po luftonte me vdekjen. Banorët vendas e kishin zhveshur dhe e kishin lyer të gjithin me një pomadë të gatuar me mjaltë dhe barëra të ndryshme, që t'i ulje e ënjtura. Një plakë solli një tufë me bimë mjekësore, i shtypëm në një havan prej druri, pasi u lëngëzua dhe nxori shkumë, ia ngrita kokën aq sa munda, dhe ia derdhëm lëngun në gojë. Ia shtrëngova nofullat me dorë, që lëngu të mos derdhej jashtë gojës, por t'i shkonte poshtë. Harallambi desh u mbyt. Filloi të përpëlitej, duke dashur të merrte frymë, por unë nuk ia lëshoja nofullat, kështu që u detyrua ta kapërdinte lëngun.

Pastaj nuk kisha se çfarë të bëja më. Prisja. U ula përtokë, në krah të tij, dhe largoja mizat. Më kishin dhënë një shishe me alkool, për çdo rast, sepse nuk isha i sigurt nëse bënte mirë apo jo, ia tundja majtas-djathtas poshtë hundës. Shtrembëronte fytyrën, sa herë që përpiquej për të marrë frymë thellë, thithte edhe avujt e alkoolit. 'Angjelonë, Angjelonë' - më thoshte sa herë vinte në vete.

Mos më vështro kështu e tmerruar, bija ime. Shpëtoi! Si linde ti nëse nuk do të kishte shpëtuar?"

Mua më morën në shtëpi si ndihmëse në vitin 1896, para se plaka të zinte shtratin, në mënyrë që të kujdesesha për Angjelonë dhe për foshnjën, - mori stafetën e rrëfimit Evrikla.

Nëna jote, Penelopa ime, kishte trup të brishtë. I kishte mbetur nga sëmundja që kishte kaluar. Në të njëjtën kohë me të ishin sëmurur edhe pesë fëmijë në fshatin e saj, të cilët mbetën të çalë, dhe dy prej tyre vdiqën. Trupi i saj ishte i lodhur. Sëmurej shpesh. Ftohej edhe kur bënte vapë. Por ti linde shëndetplotë, për inat të asaj gjuhënepërkës, e cila ishte e sigurt se fëmija që do lindte do të ishte shëndetligë.

Erdha të kujdesem për ty. Dhe bashkë me ty, të kujdesesha pak dhe për nënën tënde. Të ishe diku që të mund të shihje se sa i gëzuar ishte yt atë kur linde ti!”

“Po diku aty ishte, moj Evrikla. Përderisa kishte lindur!”, qeshi me të madhe Kallfaxhiu.

“E di ajo përse e kam fjalën. Nejse... Çfarë gëzimi ndjeu! Zemra iu bë mal!”

“I dukej sikur ishte në ëndërr!”, shtova unë.

“Shumë herë jeta është si një ëndërr, e ëmbla ime. Por mundet që në momentin pasardhës të të bëhet një makth”, shtoi Evrikla.

Fjalët që më tha mëndesha, sikur ndalën njëherësh trenin edhe kohën. Nuk e kuptoja nëse po më merrej fryma nga tronditja, apo ngaqë u befasova. Sepse po atë frazë, me po ato fjalë, m’i kishte thënë vetëm disa ditë më parë zonja Haritoglu duke dalë nga salloni magjik i modës në Izmir. Ky aforizëm më ndiqte kudo nga mbrapa. Ishte fjalë e urtë? Ishte profeci?

Por, çfarëdo që të ishte, përse po më ndiqte nga mbrapa?

“Në luftën greko-turke të vitit 1897, - vazhdoi Evrikla, - thirrën nën armë edhe babanë tënd. Një ditë erdhën në rrugicën ku ne banonim oficerë turq të rekrutimit dhe grumbulluan të gjithë burrat, vendi u shkretua. U informuam se të krishterët i dërguan në thellësi të Turqisë. Nëpër reparte ushtarake, që në fakt ishin kampe me punë të detyruar dhe kampe përqendrimi. I vinin të thyenin gurë të mëdhenj dhe të hapnin rrugë. Të hapnin rrugë aty ku nuk shkelte këmba e njeriut.

Lajmet që mbërrinin deri te ne ishin të këqija. Thoshin se i mbanin aty qëllimisht, për të vdekur, dhe, se prej tyre, të paktë do të ishin ata që do të ktheheshin. Thoshin gjithashtu se treteshin nga puna e rëndë, se ata që rrëzoheshin, nuk ishin në gjendje të ngriheshin prapë në këmbë, dhe mbeteshin anës rrugës, pa u varrosur. Lagjja ra në zi të thellë. Të gjithë në lagje ishin grekë dhe çdo shtëpi kishte një anëtar aty. Disa shtëpi kishin nga dy apo nga tre djem. E keqe e madhe i kishte gjetur!

Ajo luftë mbaroi shpejt, por kaluan pesë vjet pa marrë asnjë lajm nga Harallambi. Nuk do ishte kthyer në shtëpi gjithë ato vite? Do të duronte dot njeriu për pesë vjet dhe t’ia dilte në ato kushte? Herë e quanim të zhdukur, dhe herë të tjera këmbëngulnim se ishte gjallë. Nuk është e lehtë të ulesh në tavolinë për të ngrënë në kushte të tilla.

Netëve Angjeloja, pa bashkëshortin e saj, vyshkej, por në mëngjes rigjallërohej, dhe kjo falë teje, lulja ime, që ishe gëzimi i jetës së saj.

Por ndërkohë që Angjeloja të kishte ty, gjyshja jote nuk kishte njeri. Kishte humbur të birin, kishte humbur gjithçka. Nusja, sipas saj, nuk bënte, po ashtu edhe pjella e saj. Ti nuk mund ta zëvendësoje humbjen që kishte pësuar ajo. Kishte momente që e humbiste krejt, dilte në ballkon dhe thërriste: ‘Ku je, Harallambi im!’ - thua se do ta dëgjonte.

Kishte brengë të madhe. Sa më tepër rritej brenga e saj, brenga si nënë, kaq më shumë i binte në qafë Angjelosë së shkretë, sepse, sipas saj, nusja nuk pikëllohej mjaftueshëm për burrin e saj, dhimbja e saj nuk ishte e mjaftueshme për një burrë të tillë dhe nuk e nderonte.

Po, si ta kundërshtonte Angjeloja?

‘Po çmendem, Evrikla, - më thoshte gjyshja jote. Madje një herë e zuri një tërbim i tillë, sa zuri çekiçin dhe filloi t’i thyente gurët në oborr. Vrapuam me Angjelonë ta qetësonim. - Më lëshoni, më lëshoni, - thoshte dhe përpëlitej e tërbuar. - Kini mëshirë dhe më lëshoni, - thoshte duke qarë me dënësë, - të tilla gjëra e detyrojnë djalin tim të bëjë.’

Nëna jote, që ta kuptosh se sa shpirtmirë ishte, nuk i kundërvihet kur ajo e akuzonte se nuk e nderonte burrin e saj. Madje dukej sikur gati-gati ishte dakord me të. Atëherë më dukej e pakuptimtë, por do të të them në vazhdim se përse nuk ishte e tillë.

Gjyshja jote, që të vazhdojmë pastaj me nënën tënde, një ditë na komunikoi se nuk duronte më, do të nisej në kërkim të birit të saj. Ishte njeri këmbëngulës. Nëse i ngulej një ide në kokë, ishte e vështirë t’ia shkulje. Që nga ajo ditë filloi të mos hante. Përtypte kafshatat, sikur të ishin çamçakëz. Me orë të tëra. E përtypte, por nuk e kapërdinte. E mbante në gojë dhe e përtypte. ‘Po kapërdije, zonjë!’ - i thosha, por siç thashë, ishte njeri këmbëngulës dhe tashmë vendimin e kishte marrë. Dhe kështu bëri, derisa vdiq. Dhe, në pritje të babait tënd, mbetëm nëna jote, unë dhe ti.

Tani, të të them se përse më dukej e pakuptimtë që Angjeloja ishte dakord me pretendimin e gjyshes sate, se dhimbja e saj për bashkëshortin nuk ishte e mjaftueshme. Kur nëna jote mori të tatëpjetën dhe ishte e qartë se nuk do të ngrihej më nga krevati, dëshironte të më tregonte gjithçka, para se të ishte vonë. Duhet të dish se Angjeloja kurrë nuk e hapte gojën për të folur për veten e

saj. Nuk e shprehte atë që ndiente. ‘Harallamb’ - thoshte vetëm, dhe i shkëlqenin sytë. Por nuk i thoshte ato fjalë të ëmbla që gratë u thonë burrave.

Por, kur e ndjeu se kaq e kishte, dhe se vaji i kandilit të saj po mbaronte, befas e zuri një dëshirë për të m’i treguar të gjitha. ‘T’ia thuash fije e për pe të gjitha kur të rritet, dhe ajo do të kuptojë’, ishte porosia e saj për ty, Penelopë. Dhe unë, ç’të bëja, madje edhe e doja diçka të tillë, iu betova, përndryshe ajo nuk qetësohej.

Teksa më tregonte, më rrëfeu se gjyshja kishte të drejtë kur thoshte se brenga dhe malli i së ndjerës për të birin ishte më i madh se malli i saj. ‘Brenga dhe malli i nënës që humb fëmijën, Evrikla, - më tha dhe e theksoi këtë, -është brenga më e madhe në botë. Këtë ta them unë që po iki nga kjo botë dhe po humbas vogëlushen time.’”

Evrikla ndërpreu tregimin për të fshirë lotët.

“Kur gjendja e saj u përkeqësua, e shtruam në spitalin e kishës ortodokse në Aidini, që për kohëzgjatje, e kishte emrin ‘Shën Harallambi’. Angjelo, themi të të shtrojmë në spitalin e Shën Harallambit, do? ‘Po, po’, u përgjigj ajo, dhe filloi të kërkonte ikonën e shenjtit që kishte poshtë jastëkut, për të qenë gati.

Nuk qëndroi shumë kohë në spital, e shkreta. Kishte dhimbje dhe mua më dhimbsej për vuajtjet e saj. ‘Shën Harallambi im’, thoshte, dhe besoj se i drejtohej babait tënd.

Para se të ikte nga kjo botë dhe të shkonte në botën tjetër, ku do të takohej me babanë tënd, më detyroi t’i premtoja se do të të çoja te Kallfaxhiu në Qipro, dhe më tregoi se ku do ta gjeja letrën për të cilën je në dijeni. Më tha se kjo ishte dëshira e babait tënd. Këtë porosi i kishte dhënë, nëse do të ndodhte diçka e keqe. Nëna jote nuk e kishte njohur kurrë Kallfaxhiun, si mund ta dërgonte të bijën te një njeri i huaj, apo nuk është kështu?”

Kallfaxhiu ia bëri “po” me kokë.

“Por i kishte thënë: ‘Kallfaxhiu di të kujdeset për të dhe ta shpëtojë.’”

Shikoja jashtë nga dritarja, por pa e pasur mendjen, për të fshehur detin e lotëve që po më përmybnin. Një errësisë e lëngshme, si një bojë uji shumë e holluar që rrëshqiste mbi letër, ngjyroste malet dhe rrëshqiste drejt nesh, te treni. Na arriti dhe filloi të më mbështillte edhe mua, kur rrëfimi arriti te vdekja e prindërve të mi. Ndjeva në duart e mia lagështirën e natës të binte pikë pas pike. Pastaj, si një bimë kacavjerrëse, më mbështolli deri te gryka dhe më mbyti me dënësia të ngadalta.

“Që me vështrimin e parë që i hodha letres së nënës sate, kur ma dha Evrikla në Qipro, e dija se ajo do të ndryshonte jetën time, - ndërpreu mendimet tona Kallfaxhiu dhe më tërhoqi lehtë drejt vetes, duke ma hedhur krahun e tij rreth supeve. - Një vështrim i shpejtë, një radhë këtu, një fjalë aty, më mjaftuan për të kuptuar se ajo ditë kishte aguar si e veçantë për mua. I largova me të shpejtë shegertët dhe ula qepenat që të rrija vetëm. Në dyqan ra errësira, drita ishte e pakët, aq sa lejonin hapësirat e ngushta të qepenave dhe baxha. Jashtë vazhdonte zhurma e tregut, njerëzit shkonin dhe vinin. Por, brenda në dyqan mbretëronte qetësia dhe gjysmerrësira, ngjante me një kishë në mes të një sheshi qendror. Dhe akoma më brenda, Penelopë, brenda meje, dëgjoja rrahjet e zemrës sime si kambanë dhe shpirtin tim që ishte gati të më fliste.”

Këto tha Kallfaxhiu dhe më vendosi në dorë çelësin e shtëpisë sime prindërore. Treni kishte arritur në fund të udhëtimit. Ndodhesha në Aidinin e Harallambit dhe të Angelos.

*Dhe hipi ajo shkallëve më të larta
të pallatit, në dorë një çelës tunxhi*

të kërrusur me dorezën prej fildishi.

(...)

*Menjëherë hoqi rripin nga unaza
futi çelësin, që duke u vërtitur
tërhoqi shulet e derës që gjëmoi
posi një dem që bulurit në fushë
ashtu shungulloi dera madhështore
sa iu fut çelësi, duke u hapur n'çast¹.*

Në shtëpinë e prindërve të mi, në Aidini, u ula në krevatin e nënës sime dhe fillova të qaja, ashtu si qaja kur isha e vogël në këtë shtëpi. Qaja si fëmijë. Mbështeta kokën time në jastëkun e saj. Mbante një erë lagështire dhe vjetërsie. Fërkova me forcë hundën time pas jastëkut, por nuk ndjeva aromën e saj, ishte zhdukur me kalimin e viteve. Qava për aromën e humbur të nënës sime.

*“Mos ki frikë nga kjo dhimbje, bija ime, - më këshilloi në vesh,
- është dhimbje e vjetër.”*

*Ajo më fliste e unë me mend e zemër
nuk kisha tjetër dëshirë, veç në gj
të mundja ta shtrëngoja të shkretën nënë.
Tri herë si e dëshiruar shtriva duart
drejt saj, tri herë më shkau në krahë të mi
si hije e zbehtë, si ëndërr kur të del gjumi
Ngashërim i thellë u mblodh në zemrën time
e ngrita zënë e këto fjalë i thashë,
Pse po më ikë, o nënë? N'këtë Hades t'zi
t'shtrënguar qafë më qafë të dy së bashku².*

¹ Po aty. Kënga XXI, vargjet 6-8 dhe 62-66.

² Po aty. Kënga XI, vargjet 259-268.

U ula në tavolinën ku Angjeloja bënte tualetin, i fryva pluhurit që kishte pasqyra dhe pashë veten në të. U afrova kaq shumë, sa frymëmarrja ime u kondensua mbi të. Dallova në fytyrën time karakteristikat e saj. Vetullat e përkulura dhe buzët e mbushura. Buzëqesha dhe dallova se po më buzëqeshte edhe ajo. Befas m'u kujtua zëri i saj, i butë si i një vajze të vogël. M'u kujtua melodia nga kënga e saj e preferuar. M'u kujtua... m'u kujtua...

Vajta te dritarja. U përkula dhe mbështeta bërnylat mbi parvaz. Kështu do të kish qëndruar edhe ajo, mendova. Këtë peizazh që hapej para meje do të kishte parë edhe ajo.

E ndieja Angjelonë që më prekte, thua se ishte mbështetur edhe ajo te parvazi, pranë meje. Psherëtiva, psherëtiu edhe ajo.

Së bashku po shikonim oborrin. Dalluam kalin e karrocës që po hante i uritur nga qesja e varur te qafa e tij. Karrocieri qëndronte në vendin e vet gjysmë i shtrirë dhe pushonte duke numëruar trespiket. Në një distancë të vogël, nën një pishë, qëndronte Kallfaxhiu, ulur mbi një gur. I përkulur, pastronte baltën prej këpucëve të tij me një tufë halash pishë.

Evrikla nuk dukej gjëkund.

Një valë dashurie vërshoi përsëri në trupin tim për atë burrë. Ndjeva që edhe nëna ime ndiente po atë dashuri. E falënderova që e përzgjodhi atë për ta pasur babanë tim të dytë, dhe ajo, nga vendi ku ishte mbështetur, pranë meje, e falënderoi me vete që kishte qenë një baba kaq i mrekullueshëm për mua. I buzëqesha me buzëqeshjen e saj dhe vrapova drejt shkallëve.

Duke vrapuar arrita te Kallfaxhiu dhe u ndala para tij. Ashtu siç ishte përkulur, ngriti kokën dhe më vështroi me habi. Ia mora dorën që mbante tufën me halat e pishës, e tërhoqa duke e ngritur në këmbë, dhe e drejtova nga shtëpia.

“Dua që të kthehem i së bashku”, i thirra.

U ktheva në Izmir e rritur tashmë. Një grua e pjekur, të cilën e shoqëronte dhe i rëndonte në mënyrë të theksuar ndjesia e fatalitetit. E jetës që ecën përpara, por pa të pyetur, të nxjerr tjetërkund, apo të tërheq mbrapa. Prekja vazhdimisht në xhepin tim çelësin e shtëpisë sime prindërore, që të sigurohesha se ishte aty.

Lashë vajzën e parritur mirë në dhomën e nënës sime duke fjetur e lodhur në krevatin e saj, përqaftuar me jastëkun e saj të vjetruar nga koha, dhe u largova e qetë nga shtëpia atërore, me hapa të lehtë gruaja dhe duke mbyllur pas meje pa zhurmë derën e jashtme.

Gjatë rrugës së kthimit me tren, në atë turmë me gjithfarë njerëzish që bisedonin, thërrisnin dhe bënë shaka, kërkoja euforinë e Izmirit, tashmë, jo si një dëfrim pa mbarim, që kisha të drejtë ta shijoj, thua se më takonte, por si një pauzë shpirtërore. Si një pushim, teksa ndërgjegjësohesha se lumturia nuk ishte një gjendje që zgjaste pa mbarim, dhe fillova të dyshoj se pikëllimi që ndjeva kur isha në shtëpinë e prindërve, nuk do të ishte i fundit. Në këtë perspektivë zhvillimesh ndihesha sa e pambrojtur, po aq dhe e mbrojtur, sepse kisha pasur ndërkohë fatin të mësoj se ekzistojnë në botë njerëz si Kallfaxhiu, që “dinë të shpëtojnë”.

Me atë melankolinë prej të rriture që përftova në Aidini, mbërrita përsëri në hotelin *Kraemer*. U hodha me një kërcim nga karroca, sikur të isha, për të tjerët po flas, më shumë një fëmijë i rritur sesa një grua e re.

*N*ë dhomën e hotelit, mbi një tabaka prej argjendi na priste një piring i madh ftesash. Duke u hedhur një vështrim të shpejtë, Kallfaxhiu u ndal te ftesa e çiftit Sarej. Na ftonin t'i shoqëronim, bile që të nesërmen në darkë, në shfaqjen e operës *Traviata*, në Teatrin e Izmirit.

Ashtu siç i pëlqen jetës të luajë, në momentin që mbylli pas meje një derë, hapi ndërkohë një derë tjetër.

Im atë filloi të lëvizë ftesën lart e poshtë, para syve të mi, në mënyrë demonstrative: “Sa me fat që je! U mërzite që nuk erdhe atë ditë me mua në shkollën time të vjetër. Tani, të jepet një mundësi e re që të njihesh me mësuesin tim”.

Ia mora me padurim ftesën nga dora për ta lexuar. Pluhurin e atij udhëtimit të gjatë, e mori era menjëherë. Mori me vete dhe mendimet e zymta, thua se edhe ato ishin thjesht pluhur që kishte zënë vend mbi mua. U ktheva dhe Izmiri më ftonte përsëri t'i gëzohesha jetës. Me një letër katërkëndore krejt të parëndësishme, ia doli të më kthente përsëri gëzimin.

Duke kënduar një melodi nën buzë, hapa baulen që të ndërroja rrobat.

Kur këmba ime shkeli në Teatrin e Izmirit, nuk ia kisha idenë se jeta ime kishte ndryshuar dhe se po shkëlja në rrugën e së ardhmes sime. Nuk mund të përfytyroja se para syve të mi, Fati i Shkuar dhe e Pashmangshmja, si aleatë të padukshëm, mbillnin gjoja rastësisht, farat e jetës sime të mëtejshme.

U futëm në teatër duke vrapuar, që të mos na zinte rrebeshi që po fillonte. Ndërkohë pikat e para binin të mëdha, të rënda, të mirushqyera nga vapa dhe mungesa e reshjeve të ditëve të fundit.

Në hyrje ndalua duke dihatur, që të mbusheshim me frymë. Një bubullimë, diku aty afër, mbuloi çdo zhurmë tjetër. “Me të shtëna topi shoqërohet vajtja e Penelopës në teatër”, tha me shaka zoti Haritoglu duke ngritur zërin që të dëgjohej. Im atë i tha diçka, por zëri i tij u mbulua nga një tjetër bubullimë që pasoi të parën.

Morëm drejtimin për te lozha që ishte shkruar në ftesë. Te shkallët dhe në holl kishte kaq shumë njerëz, saqë e patëm të vështirë të kalonim. Im atë hapte rrugën i pari, dhe unë e ndiqja qorrazi. Çifti Haritoglu vinte pas nesh. Dridhësia kur mendoja se dikush nga ajo mizëri njerëzish mund të më shkelte pa dashje fustanin dhe të ma griste.

Kasandra Haritoglu lexoi mendimet e mia dhe më pëshpëriti në vesh: “Askush nuk do ta shkelë fustanin tënd, bukuroshe!”.

Duke ecur qorrazi dhe duke e mbajtur tim atë nga xhaketa që të mos më humbiste, arritëm te lozha. Shfrymë të lehtësuar që të katërt njëkohësisht. Izolimi që të ofronte lozha, ishte në atë moment diçka më tepër se e mirëpritur dhe duke qeshur me gjestin që bëmë, lëvizëm perden anash që të kalonim.

Na priti vetë zoti Sareji, mësuesi i vjetër i Kallfaxhiut.

Admiral anglez. Kjo ishte përshtypja ime e parë. Një bast të tillë do të vija, nëse nuk do ta dija se kush ishte. Ishte për të ardhur keq që ky burrë nuk veshi gjatë jetës së tij uniformë ushtarake. Jo ndonjë uniformë të çfarëdoshme. Vetëm atë të admiralit. Sepse sytë e tij, më kujtuan menjëherë detin. Ishin kaq të kaltër, saqë doje të zhyteshe në ta për të notuar. Por njëkohësisht të paralajmëronin se do ta kishe pisk nëse shkoje shumë larg. Kishte një vështrim të rrallë, vështrim që të vendoste vetvetiu kufij dhe të këshillonte që të mos i kapërceje.

Por edhe kështu, ky burrë shkëlqente, si një hënë e plotë. I rrumbullakët, me barkun të shtrënguar nga jeleku dhe fytyrëçelur. Kishte një shkëlqim të lindur që binte në sy dhe më magjepsi që në momentet e para.

Isha akoma e magjepsur, kur ai më puthi dorën.

E shoqja ishte kaq ndryshe, saqë pyeta veten e habitur, nëse kisha parë më parë një çift që të kishin kaq dallim nga njëri-tjetri. Ishte e gjatë, të paktën një kokë më e gjatë, dhe me shtat të drejtë, si ato skulpturat e lashta. Nuk kishin ngjashmëritë që fitojnë bashkëshortët gjatë viteve të jetës së përbashkët, bile as në fytyrë. Fytyra e saj ishte e gjatë dhe e hollë, me rrudha gati të padukshme, mbi të cilat rëndonin flokët e saj. Të krehur në mënyrë serioze dhe me një gërshet të vogël, që ia rrethonin fytyrën.

Zonja Sareji na uroi mirëseardhjen në frëngjisht, me një arrogancë të dukshme, por që e zbuste sjellja e saj plot edukatë. Ia ktheva edhe unë përsëritjen në frëngjisht, me fjalët më fisnike që më kishte mësuar madam Simona. Më dha një buzëqeshje që unë do ta quaja të ftohtë, nëse nuk do ta kishte shoqëruar me një gjest miqësor, duke më ftuar që të ulesha në krah të saj.

Nga një distancë e tillë e afërt kisha mundësinë ta studioja më mirë. Gërsheti i saj pothuajse i prekte zverkun. Mendova se kështu krihej përditë, pasi gërsheti ishte thurur në mënyrë aq të rregullt, sa krehja mund të përsëritej lehtësisht. Por, në rastin e kësaj zonje, kjo rregullsi nuk rrezatonte bukuri, por ashpërsi. As edhe një qime floku nuk kishte lejuar që të thyente rregullin e krehjes së duhur.

Ishte e dukshme se stolitë e saj shumëngjyrëshe, që binin në sy, dhe kapela e saj me pendë të mëdha, që ofrohej në sallonet e modës së asaj kohe, nuk kishin se çfarë t'i shtonin asaj gruaje.

Habitesha sesi mund të ishin mikështa me mendjehapurën, zonjën Haritoglu. Nuk mund ta merrja me mend sesi ajo mund të qeshte me gjithë zemër. Nuk mund ta përfytyroja as edhe duke

diskutuar pa kokëçarje, apo duke u dëfryer me shakatë e zonjës Haritoglu. Prandaj u habita kur e pashë të përkulej në drejtim të saj dhe të pëshpëriste diçka, me intimitetin e mikes së ngushtë, dhe zonja Haritoglu të qeshte me të madhe.

Gjatë kohës që zonjat ishin duke biseduar mes tyre, unë rregullova me takt fustanin dhe mbështeta butë duart mbi gjunjë, që të mos zhubrosej. U ktheva dhe i buzëqesha vajzës së re që ishte ulur në krahun tim të djathtë.

Paraqitja e jashtme e Odetës tradhtonte mëdyshjen e natyrës, kur ftohet të martojë prindër me tipare kaq të ndryshme. Kishte shtatin e bukur të nënës së saj, por pa madhësinë e saj, kishte sytë e kaltër të të atit, por pa diellin brenda tyre. Nuk munda të mos e krahasoja me veten, me sqimën natyrale të femrës që dëshiron të sigurohet për bukurinë e saj. Odeta, pa ndonjë bukuri të veçantë, rrinte e qetë dhe vështronte e heshtur platenë. E pikasi që po vështroja në drejtim të saj, u kthye dhe ma ktheu buzëqeshjen. U përkula dhe unë përpara, që të ndiqnim së bashku lëvizjet në plate.

Teatri i Izmirit, me faqen e bukur ballore, të përgatiste për atë që do të shihje në brendësi. Kisha dëgjuar se ishte një kopje në miniaturë e “Operës së Parisit”. Ishte me të vërtetë kaq i mrekullueshëm, sa edhe fama që kishte marrë.

Vështroja e mahnitur nga lozha ime platenë, lozhat përballë, skenën e madhe, perdet e trasha me palat e thella, muzikantët që zinin vendet, spektatorët që mbërrinin vazhdimisht, në çift, apo grupe miqsh.

Teatri pothuajse ishte mbushur. Zonjat, me veshjet e tyre ngjyra-ngjyra, bënë që nga lart plateja të ngjante me një det shumëngjyrësh, që dallgëzonte në mënyrë të parregullt. Megjithëse të gjithë flisnin me zë të ulët, pëshpërimat arrinin deri te ne si një zë i lartë, i pakuptueshëm.

Gjatë gjithë kohës, në pritje të ziles së tretë, zoti Sareji qëndronte si një shkëmb në mes të oqeanit dhe mbikëqyrte ambientin, me

eksperiencën e mësuesit që është mësuar të mos i shpëtojë asgjë. Si mësues. Sepse ai ishte mësues i lindur.

Me dylbitë e mia prej fildishi vështrova për pak muzikantët: violinistët, që mbështesnin violinat në sup dhe fshinin harqet, trombistët, të cilët me gjeste ushtronin muskujt e fytyrës, pianistin, që hapte dhe mbyllte gishtërinjtë duke biseduar me atë që kishte në krah.

Dhe një moment, teksa vështroja, u hutova.

U hutova dhe vështrimi im u ngul në lozhën përballë që ishte bosh. Para syve të mi, Fati i Shkruar dhe e Pashmangshmja, kishin zënë vendet e tyre tashmë, pa rënë në sy dhe pa lënë gjurmë. Do të më shikonin që i vështroja dhe do të më bënin shenja dhe gjeste. Ndoshta dhe grimasa, duke qenë të sigurt se unë nuk i dalloja, ndërkohë që përveshnin mëngët për të përfunduar veprën e sotme: të mbushnin boshllëkun e jetës boshe të një vajze. Kishin mjaft punë për një natë të vetme. Fillimisht u përpoqën të mbushnin vështrimin tim. Dy qiej, pa orientim të qartë.

Ashtu si maestroja që bëhet gati për të drejtuar orkestrën, Maestrot e Maestrove, Fati i Shkruar dhe e Pashmangshmja, vetëm me një shenjë ngritën tingujt e ngatërruar të platesë dhe, me një të fryrë, i dërguan nga lozha e tyre, përballë, tek unë, duke shquar prej bisedave të zhurmshme, disa fjalë. I shquanin fjalët një e nga një, ashtu si njerëzit, të përkulur, ndajnë grurin nga të korrat, ose vajzat e vogla, ndajnë mënjane guaskat prej guralecëve që sjell deti. Ishte gjithmonë një fjalë e vetme. Po ajo fjalë. “Dashuri.” “Dashuri.” Si ledhatim e ndieja këtë “dashuri”, zgjata qafën për ta dëgjuar më mirë dhe, në atë moment, besoja, dallova dhe emrin tim. “Pe-ne-lo-pë.” U ktheva e habitur andej nga ishte ulur zonja Haritoglu. Dhe, tek po kthehesha, ato fjalë pushuan!

Derisa të vendosej qetësia e plotë, maestroja e mbante shkopin lart. Dritat u fikën gradualisht, ashtu si ndodh kur bie nata. Shiko

se çfarë qetësie në teatër, mendova, është i etur për të dëgjuar muzikë. Sytë e të gjithëve ishin ngulur te shkopi i dirigjentit, që mbetej i palëvizur, në qëndrim gatitu. Derisa më në fund lëvizti, u përkul lehtë nga e djathta dhe, me këtë lëvizje, u dëgjuan tingujt e violinave. Notat e para ishin të buta, rridhnin qetë, nuk po më përgatisnin për gufim ndjenjash.

“Violetaaaa!” Në aktin final, kreshendoja e zhgënjimit të Alfredos, duke parë se si po vdiste e dashura nga tuberkulozi, jo vetëm mua, po nuk la njeri pa e emocionuar.

Me “a”-në e fundit të britmës së tij, aty ku Alfredo kishte mbetur pa frymë, në lozhën përballë meje, Fati i Shkruar dhe e Pashmangshmja vunë njëkohësisht gishtin në kokë dhe ma bënë me shenjë: “E pe? Ta mbash mend!”

E tronditur, kërkova dorën e Odetës dhe ia shtrëngova fort. Edhe dora e saj ishte e ftohtë.

Kur dritat u ndezën përsëri, unë sikur u ktheva nga një vend shumë, shumë i thellë, ku kisha shkuar. Ato dy figura të padukshme në lozhën përballë meje ishin larguar.

U larguam të fundit nga teatri, për të shmangur rrëmujën gjatë daljes. Qëndronim të heshtur dhe shikonim platenë të boshatisej, a thua se batica po e tërhiqte drejt bregut jashtë, atë det shumëngjyrësh spektatorësh.

U ktheva përsëri në tokë dhe dëgjoja tim atë që fliste për gjueti.

“Bëni gabim, i dashur im, - korrigjonte zotin Haritoglu zoti Sareji, - por do të lë zotin Kallfaxhi ta gjykojë nesër.”

Vështrova tim atë me habi.

“Penelopë, ne burrat nesër do të shkojmë për gjah, - më komunikoi ai. - Mos u shqetëso. Po shkoj me mësuesin tim”, më qetësoi ai.

*D*he nesër kur Agimi me gishtërinjtë
e vet të trëndafiltë shkëlqeu,
të bijtë e Autolikut me langonj
për gjah dolën, me ta edhe Uliksi¹.

“Vajti edhe im vëlla për gjah bashkë me të tjerët! - më tha Odeta të nesërmen duke më uruar mirëseardhjen. - Sa keq! Dhe doja kaq shumë që ta njihje, Penelopë!”, shtoi ajo.

Odeta ma tregoi kopshtin e shtëpisë së saj. Shtrihej në pjesën e prapme dhe ishte kaq i madh, saqë shtëpia dhe shkolla e ndanin mes tyre. Një rresht i gjatë me dymbëdhjetë pemë dardhe dhe dhjetë pemë molle, formonin një rrugicë, që të çonte te shkolla. Kopshti përfundonte te godina e shkollës. Pavarësisht se ishte shumë i madh, ishte ndërkohë tejet i mirëmbajtur. Rrethohej nga një mur i lartë guri, që mezi e mbulonin bimë kacavjerrëse. Pothuajse në mes të kopshtit, ishte një pemë shumë e lartë eukalipti. Më tutje, një shelg i madh vajtues, degët e të cilit fshinin tokën dhe, akoma më tutje, pak mënjanë, një pishë e stërmadhe, degët e së cilës hynin dhe tek oborri i fqinjit.

Ana e majtë e kopshtit ishte e mbjellë me fiq.

“Dyzet! Mos e merr mundimin t’i numërosh”, më tha Odeta.

Shtëpia e Sarejve, ashtu siç e shihja nga thellësia e rrugicës, ngjante më mbresëlënëse, dy katet e saj dhe një i tretë, më i ulët,

¹Po aty. Kënga XIX, vargjet 551-554.

që ndriçohej nga dritare më të vogla me grila në ngjyrë jeshile. Ajo ishte projektuar në mënyrë të tillë, që në njëfarë mënyre, të shfaqte dy faqe të saj. Ulur në kopsht, nuk shihje faqen e pasme të shtëpisë, por një tjetër faqe kryesore. Një shkallë e gjerë prej mermeri, të drejtonte nga shtëpia në kopsht. Ishte kaq mbresëlënëse kjo shkallë, saqë mendoja se ia vlente të ishte hyrja kryesore që priste njerëzit, dhe jo të shihte gjithë kohës fiqtë.

Vizita me Odetën përfundoi te këndi i ndenjes, poshtë eukaliptit, ku na priste ndërkohë zonja Kasandra Haritoglu.

“Shpejtoni vajza! - na thirri sapo na pa, në zërin e saj dallohej padurimi. - Po bëni sikur Penelopa nuk ka parë ndonjëherë pemë fiku!”

Nën hijen e pemës kishin sajuar një kënd veror, me stola të zbukuar, me jastëkë të vegjël ngjyra-ngjyra. Rreth një tavoline, të cilën e mbulonte tejtejet një mbulesë e gjatë me lule të qëndisura, ishin vendosur karrige dhe kolltukë të vegjël prej xunkthi, me jastëkë të hollë dhe thekë të gjatë. Njëra prej karrigeve ishte tërhequr mënjanë dhe në vend të saj ishte vendosur një shezlong prej xunkthi. Një libër i hapur dhe një freskore e mbyllur tregonin se dikush, zonja Sareji sigurisht, e kaloi aty mëngjesin.

Në krah të shezlongut ishte shtrirë një qen i madh në moshë. Sapo më pa, ngriti kokën dhe zgjati veshët.

Prapa tyre

një qen i shtrirë ngre kokën dhe zgjat veshët¹.

Qeni lehu dhe Odeta ktheu me habi vështrimin nga unë.

Zonja Sareji na uroi mirëseardhjen, që nga kreu i shkallës prej mermeri, me një “Mirdita, mikeshat e mia të dashura”, të ngrohtë në frëngjisht, e cila, megjithatë, kumboi e ftohtë. Megjithëse ishte shumë e gjatë, i zbriti me lehtësi shkallët dhe na u afrua si një vegim

¹ Po aty. Kënga XVII, vargjet 371-372.

transparent veshur me të bardha. Flokët e saj, ashtu siç e prisja, ishin të krehur njëloj si një natë më parë në teatër. Mbante varur një gjerdan shumë të gjatë me perla, me një të dyfishtë në gjoks.

Edhe mua nga hutimi më ishte bërë një nyjë në grykë. Zonja Sareji, me rreptësinë që përçonte, dhe Odeta me ndrojtjen e saj, që gabimisht e konsideroja si ngathtësi, bënin që unë të rrotullohesha në karrigen time pa gjetur rehat. Qeni qëndronte pa lëvizur, me vështrimin të ngulur tek unë dhe po më studioje nga vendi ku ishte shtrirë. Madje edhe ai, me vëzhgimin e tij këmbëngulës, më bënte të ndihesha keq.

“Është qeni i vëllait tim”, tha Odeta.

... ishte qeni Argus i Ulksit¹.

“Për atë Zot, - u hodh zonja Haritoglu, - se mos pyet që të mësosh për qenin, se kam frikë se përgjigjja do të zgjasë shekuj!”

Odeta u përkul dhe e ledhatoi. U përkula që të bëja edhe unë të njëjtën gjë. Qeni ma lëpiu dorën miqësisht dhe ajo nyjë që kisha në grykë u zhduk.

“Vëllai im... Xhoni, jo Fredi, një ditë u kthye nga gjuetia me çantë të fryrë. U mblodhëm rreth tij të admironim gjahun e vvarë dhe, atëherë, ai nxori nga çanta një këlysh qeni gjysmë të vdekur. ‘Ju solla një lepur të butë’, na tha.”

Nga qeni, biseda kaloi te shfaqja e “Traviatës” që ndoqëm një natë më parë, dhe prej andej te veprat që do të shfaqeshin sezonin e ardhshëm dhe te aktorët e famshëm që do të vizitonin Izmirin. Një tespihe temash, rruazat e së cilës i luante nëpër gishtërinj - e kush tjetër? - zonja Haritoglu me humorin e saj të lindur dhe të qeshurën kumbuese.

Kasandra hidhej si flutur nga njëra temë në tjetrën, na tregonte me entuziazëm të rejtat e ditës, na tregonte e na tregonte vazhdimisht

¹ Kënga XVII, vargu 373.

lajme të reja, a thua se në Izmir ndodhte çdo gjë dhe të gjitha ishin lajme që ia vlenin të tregoheshin, se dje nuk kishte ndodhur asgjë kaq e rëndësishme, dhe asgjë më e rëndësishme nuk kishte për të ndodhur nesër.

Kështu i sollën ngjarjet Fati i Shkruar dhe e Pashmangshmja, dhe unë kalova një ditë të plotë me Sarejit në shtëpinë e tyre. Isha e entuziazmuar që njoha më në fund shkollën e vjetër të tim ati. Sigurisht, atëherë nuk e dija se kjo nuk ishte arsyeja e vetme pse duhej të isha e entuziazmuar.

Pas buke, Odeta kërkoi të na shërbenin kafënë në *patio* ose oborrin spanjoll. Më mori për dore dhe po drejtoheshim me ngadalë për atje. Nuk kisha parë tjetër të ngjashëm me të, kaq të gjerë dhe të çuditshëm. Siç më shpjegoi Odeta, projektin e kishin sjellë nga Anglia. Ishte i projektuar për klimën e ftohtë të atyre vendeve dhe u detyruan ta përshtatnin për klimën e ngrohtë të Izmirit. Kishin porositur mentesha të posaçme, në mënyrë që dritaret të hiqeshin me lehtësi në pranverë.

Kështu ishte kur e pashë unë atë ditë, dhe më tepër ngjante me një fole të papërfunduar prej qelqi. “Në vjeshtë, - shtoi Odeta, - i vendosim përsëri dritaret, vendosim brenda saksitë me lule që nuk e durojnë të ftohtin, varim kafazin me kanarina, dhe ambienti nga një fole shndërrohet në *patio*.”

Duhet të vish dhe ndonjëherë në dimër, - më ftoi ajo. - Është shumë bukur të rrih në ambientin e mbyllur të *patio*-s, e të shijosh diellin e dimrit. Shullëhesh në diell pa pasur ftohtë.”

Ia premtova. Një premtim sa për të kaluar radhën.

Të marrë atë që vetë fati do t'i ketë caktuar¹.

“Vetëm kujdesu që kur të vish të jetë ditë me diell, - më porositi ajo. - Edhe kur bie shi bukur është, e sheh dhe e dëgjon kur pikat bien mbi xhamat e strehës. Por më bukur është kur ka diell”, më tha me modesti.

¹ Kënga XVI, vargu 476.

Odeta u bë mikja ime më e mirë në Izmir. Vinte dhe na merrte, mua dhe Evriklën, në mëngjes nga hotel *Kremer* për të na shëtitur nëpër qytet. Ajo ishte njëzet e dy vjeç dhe unë shtatëmbëdhjetë, por kjo diferencë për ne ishte e vogël. Vazhdimisht zbulonim se kishim pika të përbashkëta, dhe këto na afronin gjithnjë e më tepër.

Odeta rezultoi shpirti im binjak. Adhuronte letërsinë franceze të periudhës romantike, njëlloj si unë! Evrikla nuk thoshte gjë tjetër veç lëvdata dhe fjalë të mira për karakterin brilant dhe për modestinë e mikeshës sime.

Bashkë me të shkova në kinema për herë të parë në Izmir. Në kinoteatrot *Pate*, *Pallas* dhe *De Pari*. Në errësirën e sallës, të zëna dorë për dorë, qanim pa zë, jo vetëm duke ndjekur, por edhe duke përjetuar, dashuritë platonike në filmat bardh e zi. Kur ndizeshin dritat, largoheshim, të ngopura me veprën, sytë të skuqur dhe hundën të ënjtur.

Njëherë, pas një vajtje të tillë në kinema, që u shoqërua me lot si herët e tjera, Odeta nxori nga çanta e saj e vogël një fotografi. Në fillim hezitonte, e nxirrte dhe e fuste përsëri në çantë. Por, më në fund, ma tregoi. Ishte fotografia e një zotërie të ri në moshë. Natyrisht që ia mora nga dora dhe po e vështroja me vëmendje. Fytyra e tij ishte pothuajse pa të meta. Ngjante me aktor kinemaje. Kishte sy shumë të bukur, një hundë të skalitur, buzë të mrekullueshme, mustaqe të prera me kujdes.

“Kush është ky?”, e pyeta me një zë që ishte akoma i mbytur nga të qarët.

Odeta, me një zë të ngjashëm me timin, më tregoi se ishte njeriu që ajo dashuronte. “Do ta dashuroj përjetë!”, më tha në mënyrë melodramatike, si të qe aktore e ndonjë vepre kinematografike. Më tha se u njoh me të në një pritje te shtëpia e një miku të familjes. “Është nga Greqia. Kishte ardhur në Izmir për një udhëtim disaditor, si shoqërues i një komisioni juristësh. U kthye në Athinë, Penelopë! U largua pa më thënë asgjë. Nuk më lajmëroi. As që më përshëndeti”, shtoi ajo e trishtuar.

“Dhe nuk të dërgoi as edhe një fjalë?”, e pyeta unë e zhgënjyer, sepse në filmat romantikë, të dashuruarit gjejnë gjithmonë një mënyrë për të komunikuar me të dashurat e tyre.

Tundi kokën në mënyrë mohuese dhe tërhoqi përsëri hundët e saj. “Do ta pres! - deklaroi me një vendosmëri, që ishte e huaj për atë vajzë të ndrojtur. - Jam e sigurt që do të kthehet. Ke për ta parë! - shtoi me këmbëngulje. - Penelopë, nuk mund të jetoj pa të! - vështroi edhe një herë fotografinë e tij dhe pastaj e fshehu në çantën e saj. - Do ta pres! - vazhdoi monologun e saj. - Do ta pres aq sa do të duhet. Edhe një jetë ta prisja, pak do të ishte. O atë, o asnjë tjetër!”

Të lidhura edhe më shumë me njëra-tjetrën, morëm rrugën e kthimit për në *Ke*, duke vështuar me melankoli detin e thellë dhe të zi nga errësira e natës, atë det që mori dhe akoma nuk e ka kthyer djaloshin e bukur të *Odetës*.

Me lot në sy, por të çliruara shpirtërisht, u ndamë jashtë hotelit *Kraemer*.

Ditën që do të merrnim rrugën e kthimit për në Kerinia, u zgjova shumë herët nga një ëndërr nga ato që Evrikla i konsideronte profetike dhe pretendonte se dinte të shpjegonte saktë simbolikën e tyre.

Siç e kishim zakon, para se të më dilte mirë gjumi, shkova te krevati i saj dhe i tregova ëndrrën, ashtu siç e mbaja mend. Ishte një ëndërr e trazuar dhe Evrikla, me shumë mundim përpiqej të gjente interpretime të arsyeshme për absurditetet e saj.

I tregova për kalorësin që po vinte me një anije, i cili, ndërkohë që më kërkonte, më kaloi pranë pa më njohur. E ndiqte nga pas me gjuhën jashtë, një qen në gjendje të mjeruar, i cili kur më pa, u kthye dhe erdhi në drejtimin tim, më lëpiu dorën me gjuhën e tij të tharë dhe të etur për ujë. Në atë moment unë u përkula dhe hodha ujë në pëllëmbën time nga gota e mëllagës së Katinës, që e mbaja në dorë. E piu të tërë, me një gllënjë, dhe më buzëqeshi, aq sa

mund të buzëqeshë një qen. Nejse, qeni i ëndrës sime më buzëqeshi dhe u kthye duke vrapuar tek i zoti, i cili, duke kalëruar, kishte avancuar shumë përpara. Unë dalloja vetëm majën e kokës së tij, që ishte në ngjyrë të kuqe.

“Me gjak?”, pyeti Evrikla.

“Jo. Dukej sikur në vend të kokës, kishte diskun e zjarrtë të diellit.”

“Kur lind, apo kur perëndon?”

“Kur lind”, iu përgjigja, megjithëse nuk isha e sigurt.

Evrikla, pasi u mendua pak, nxori konkluzionin e saj.

... nuk është ëndërr kjo që sheh me sy

po paralajmërim: kështu do të ndodhë¹.

“Penelopë, sot ke parë në ëndërr ato që do të të ndodhin.”

“Hajde tani, Evrikla ime e mirë, më trego për ato që do të më ndodhin”, iu luta dhe qëndrova ndenjtur për të dëgjuar vazhdimin.

“Gjithçka do të shkojë mirë, - më qetësoi ajo. - Gjithçka do të shkojë mirë. Dua vetëm që sytë t’i kesh të drejtuar nga deti. Prej andej do të vijë.”

“Kush do të vijë nga deti?”, nuk po kuptoja mirë se çfarë po më thoshte.

“E ardhmja jote. Lumturia jote. Si të ta them më mirë, bija ime?”

Nga dritarja e hotelit pashë avulloren e kapiten Agathangjellos, që po i afrohej Izmirit. Kur e vura re, fillimisht në vijën e horizontit, dukej shumë e vogël, sa një kokërr. Si koka e një gjilpëre në një pëlhurë bojë qielli që valëzonte, kështu dukej.

E mbështetur te parvazi i dritares, e shihja të rritej në përmasa dhe t’i afrohej dritares sime. Qëndrova aty derisa hodhi spirancën. Tri herë më përshëndeti me sirenën e saj dhe unë ia bëja me dorë, në shenjë mirëseardhjeje.

¹ Kënga XIX. Vargu 688.

U përkula më shumë për të parë njerëzit që dilnin në kalatë, por nuk munda të dalloj asnjërin. Shihja një grumbull njerëzish që shkonin dhe vinin në port, me kapela europiane, por edhe me feste.

U futa në dhomë, mbylla baulen time dhe vrapova drejt sallonit të pritjes për të lajmëruar babanë tim: anija që do të na merrte, mbërriti.

Duke mbyllur derën, pashë perden e dhomës, te dritarja e hapur, të tundej si vello e bardhë e nuses.

Udhëtimi i kthimit është i ëmbël. Edhe më i ëmbël akoma është momenti kur sheh njerëzit e tu të dashur duke të pritur. Gjithçka që të pret. Prehri i tyre është limani yt në stere, dyfish mikpritës së bashku me njelmësinë e mungesës. Të përqaftuar me mall, rruga për në shtëpi është e ëmbël. E ëmbël do të ishte rruga dhe nëse do të qe e përpjetë dhe e vështirë.

Mbërrita në shtëpinë tonë në Kerinia e përqaftuar me nënën time, e cila sillej sikur i kisha munguar për vite të tëra. Im atë mbante në duar Filipin dhe Fotin, të cilët, megjithëse fëmijë të rritur, nuk patën turp t'i hidheshin në krahë në sy të njerëzve, si majmunë të vegjël.

Evrikla ecte mbrapa nesh, duke mbajtur në dorë si trofe, lulemëllagën e Katinës, në gotën e ëndrrës sime. Edhe më mbrapa, njëri andej e tjetri këtej, vinin hamejtë me baulët dhe çirakët e dyqanit.

Asgjë nuk kishte ndryshuar dhe, njëkohësisht, çdo gjë kishte ndryshuar.

Po atë ditë që u kthyem, u shtriva në tapet duke zgjedhur rombin më të mirë dhe më të ndriçuar prej diellit. Një romb nuk më nxinte më. Tashmë isha rritur shumë për tapetin tonë. Hapa vend dhe për Filipin dhe për Fotin, që erdhën dhe u shtrinë pranë meje, ngjitur, thua se gjatë verës bënte ftohtë.

Vendosa gërshetin tim në dorën e Fotit dhe fillova rrëfimin. Ngjante si përrallë, vetëm se ishte plotësisht e vërtetë.

Katinën e gjeta në kuzhinë shumë të mërzitur duke shtrënguar mëllagën e saj të kuqe. Unë me Evriklën prisnim që lulja do ta gëzonte shumë, por ajo ishte veshur me të zeza. Sapo zbrita në kuzhinë, e gjeta me lulen e kuqe në dorë, veshur me rroba të zeza, u trondita. Ngjante si një nuse e ve me buqetën e luleve të përgjakur. E ulur në karrige, me sytë të mbyllur, lëkundej para dhe mbrapa pa pushim. Diçka mërmëriste, por nuk kuptohej asnjë fjalë.

Dënesat e saj ishin të pashpjegueshme. Kush ishte shkaku: shtëpia e saj, lulemëllaga, apo Jordani që vdiq? I kërkoja Evriklës të ma shpjegonte, por ajo më thoshte se njeriu nuk është si ëndrrat, që të mund ta interpretonte. “As ti nuk mundesh”, më tha, ngaqë e kuptoja Katinën më mirë se kushdo tjetër.

Pas pak ditësh, një mëngjes, na priti në kuzhinë Katina jonë e mëparshme. Kishte harruar përse qante, këtë shpjegim fëmijëror më dha. Sigurisht që nuk e besova. Si mund të harronte dikush gjithë atë të qarë? Isha e sigurt se arsyeja ishte tjetër, e mbante mend mirë dhe, madje, kishte lidhje me lulemëllagën, sepse sa herë që vështronte lulemëllagën e saj në saksi te dritarja, psherëtinte.

“Nuk është psherëtimë. Është e qarë mbyturazi”, më korrigjoi Evrikla.

Sado që u përpoqa, nuk gjeta shpjegim se përse Katina qante mbyturazi.

Shumë shpejt, për fat të keq, kisha edhe unë arsye për të qarë mbyturazi. E qara ime mbyturazi, që të mos e kuptonte Evrikla, vazhdoi për muaj të tërë, deri dimrin tjetër kur humba dadon time.

Që atëherë kur u kthyem nga Izmiri, u duk që Evrikla nuk ishte mirë. Këtë herë shenjat ishin për të dhe ishin ogurzeza. Filloi të shkrihet si qiri. Të shkrihej kaq ngadalë, sa nuk e mora vesh se kur filloi e keqja. Katina përpiqej të më përgatiste, “po mbaron vaji i kandilit të saj”, por unë çdoherë, e prisja bisedën në mes si me thikë.

I kërkova Katinës dhe sollëm vaj të bekuar nga Manastiri i Pafos, nga kandili i Shën Mërisë, për të cilin kisha dëgjuar se ishte çudibërës. Më ndihmoi dhe e lyem Evriklen nga koka deri te këmbët.

“Po e tepron, - më thoshte Katina. - Nëse është e thënë të shpëtojë, do të shpëtojë.”

Por unë e kisha gati përgjigjen, kaq e vendosur isha që t’ia shpëtoja jetën dados sime. “Katina, edhe Akili një thembër kishte të pambrojtur dhe andej i erdhi vdekja.”

“Nuk është këmbëngulje, - u thoshte nëna ime të tjerëve kur i ankoheshin se isha bërë e padurueshme. - Është zemërim, sepse po e kupton që po e humbet.”

Ditë pas dite, Evrikla bëhej edhe më e zbehtë, dhe e dobët. Mori një ngjyrë të verdhë, ngjyrë të ligësht. E mbaj mend me një neveri të tillë, saqë gjatë gjithë jetës sime të mëvonshme, unë iu shmanga ngjyrës së verdhë të çdo nuance.

I sillnim ilaçe dhe bimë të egra mjekësore, por nuk kishte përmirësim. Përkundrazi, diuretikët e shumtë e kishin dobësuar kaq shumë, saqë nuk ishte në gjendje të rrinte në karrige. E ngrinim në krahë dhe e vendosnim pranë dritares, në një kolltuk me krahë të lartë.

Nga fundi, e lidhja në kolltuk me një lidhëse të trashë, se përkulej dhe rrëzohej përpara. Kaq shumë kishte rënë. Kishte filluar të më rrëshqiste nga duart, si diçka jolëndore.